



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovë
Qeveria – Vlada- Govenment

2010-2012

**STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT
KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR KONTROLLIN DHE
GRUMBULLIMIN E ARMËVE TË
VOGLA DHE TË LEHTA**

Azhurnim i Strategjisë së Kosovës për Kontroll të Armëve të Vogla, e miratuar nga Qeveria më 24 prill
2008

Tetor 2009, Prishtinë



**STRATEGJIA DHE PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR KONTROLLIN DHE GRUMBULLIMIN E ARMËVE TË VOGLA
DHE TË LEHTA
2010-2012**



Mesazhi i Ministrit

Strategjia për Kontroll dhe Grumbullim të armëve është hartuar në vazhden e përpjekjeve dhe përkushtimit tonë të vazhdueshëm që edhe më tutje të zhvillojmë sigurinë e qytetarëve tanë. Sipas vlerësimeve të dhëna është vërtetuar se përdorimi i armëve të paligjshme paraqitet si kërcënues i vazhdueshëm i qytetarëve tanë, e veçanërisht i jetës së fëmijëve. Ekzistojnë mjaft raste kur fëmijët veçanërisht, kanë pësuar nga pakujdesia në familjet e tyre.

E hartuam këtë Strategji sepse duam të zhvillojmë politika strategjike përmes implementimi të të cilave do të sigurohemi që Republika e Kosovës të jetë një vend i sigurt për të gjithë ne, për të tjerët që vijnë në Kosovë dhe veçanërisht për fëmijët tanë të cilët nuk duhet të presim jetën nga pakujdesia dhe papërgjegjësia e individit. Kemi obligim njerëzor e institucional që ta ruajmë jetën por sidomos kemi obligim prindëror që fëmijët të rrisim në një ambient të sigurt për ta.

Kjo strategji e publikuar tregon synimet tona strategjike afatmesme. Kjo strategji tregon si duam të jetë Kosova në vitet në vijim. Përmes kësaj strategjie ne mobilizojmë edhe shoqërinë civile e cila është një partnere shumë e çmuar e Kosovës demokratike.

Strategjia për Kontroll dhe Grumbullim të armëve e hartuar për herë të parë në Republikën e Kosovës dhe Plani i Veprimit janë dokumente të cilat konfirmojnë edhe një herë se sundimi i ligjit është prioritet absolut në platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Është hera e parë që në Kosovë do të implementohet Ligji mbi Armët, përmes së cilit do të jepet mundësia qytetarëve të Kosovës të kenë në pronësi armë në mënyrë plotësisht të rregullt dhe ligjore. Kjo do të vlejë për të gjithë qytetarët që përmbushin kriteret e përcaktuar me ligj. Ligji mbi Armët është plotësisht në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe të Kombeve të Bashkuara dhe këtë mund ta vëreni gjatë leximit të Strategjisë. Është e ditur se synimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës është Kosova Demokratike, anëtare e Bashkimit Evropian, NATO-s dhe anëtare e Kombeve të Bashkuara.

Përfundimisht më duhet ta theksoj se siguria ndaj jetës e pronës së qytetarëve të Kosovës është mision i shenjtë dhe jetësor i Institucioneve të Kosovës. Sfida do të ketë vazhdimisht, padyshim. Por ne do të tejkalojmë ato dhe do të ngadhënjëjmë, gjithnjë. Ne që jetojmë sot, kemi fatin historik për ndërtimin e demokracisë dhe rendit ligjor. Kemi fatin historik që kemi kaq shumë miq që ndihmojnë dhe kujdesen për Kosovën vazhdimisht. Gjeneratat e ardhme do të në gryojnë nga veprimet që ne bëjmë sot. Andaj dua të thërras të gjithë, përmes këtij mesazhi që ta ndërtojmë shtetin e Kosovës ashtu siç ëndërruan dhe duan të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë.

**Ministri i Punëve të Brendshme
Zenun Pajaziti**

PËRMBAJTJA

Mesazhi i Ministrit.....	3
SHKURTESA	5
I .HYRJE.....	7
II. VIZIONI DHE MISIONI	8
III. Metodologjia.....	9
4.1 Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë	10
4.2 Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut	10
4.3 Parimi i kujdesit shëndetësor	10
4.4 Parimi i garantimit të sigurisë së të gjithë qytetarëve.....	10
4.5 Parimi i vazhdimësisë.....	10
4.6 Parimi i gjithëpërfshirjes	10
4.7 Parimi i ndarjes së përvojave dhe përgjegjësiive dhe qasja e përbashkët.....	10
4.8 Parimi i të drejtës për informim	11
V. MEKANIZMAT LIGJORË	12
VI. Objektivat e përgjithshme dhe lidhja me fushat funksionale:.....	12
6.1. <i>FF 1. Kontrolli ndërkufitar</i>	13
6.2. <i>FF 2. Korniza legislative dhe çështjet rregullative</i>	13
6.3. <i>FF 3. Informatat, statistikat dhe hulumtimet menaxhuese</i>	16
6.4. <i>FF 4. Vetëdijesimi për AVL dhe strategjia për komunikim</i>	17
6.5. <i>FF 5. AVL, Grumbullimi i municionit materieve shpërthyesë</i>	17
6.6. <i>FF 6. AVL, Shkatërrimi i municionit materieve shpërthyesë</i>	17
6.7. <i>FF 7. Menaxhimi i stoqeve</i>	18
6.8. <i>FF 8. Zhvillimi i kapacitetit</i>	18
6.9. <i>FF 9. Zhvillimi i komuniteteve më të sigurta</i>	18
6.10. <i>FF 10. Monitorimi dhe vlerësimi</i>	19
6.11. <i>FF 11. Lidhja me RSS.....</i>	19
VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL.....	20
7.1 Komisioni kombëtar për AVL.....	20
7.2 Koordinator kombëtar.....	20
7.3 Sekretariati.....	24
7.4 Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës	20
7.5 Roli i Ministrisë së Drejtësisë	21
7.6 Roli i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Doganat e Kosovës.....	21
7.7 Roli i Ministrisë së Shëndetësisë.....	21
7.8. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.....	21
7.9. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.....	22
7.10. Ministria e Energjisë dhe Minierave	22
7.11. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.....	22
7.12. Këshilli Gjyqësor i Kosovës	22
7.13. Zyra e Prokurorit të Kosovës	22
7.14. Enti Statistikor i Kosovës.....	22
7.15. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.....	22
7.16. Ministria e Punëve të Jashtme.....	22
7.17. Agjencia për Inteligjencë e Kosovës.....	22
7.18. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	22
7.19. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	23

VIII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	23
IX. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË.....	23
9.1 Roli i sistemit monitorues	23
9.2 Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim	23
9.3 Përzgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit.....	24
9.4 Treguesit e ndërmjetëm	24
X. PLANI I VEPRIMIT.....	25

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AIK	Agjencia për Inteligjencë e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
PK	Policia e Kosovës
DK	Doganat e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KE	Këshilli i Evropës
OJQ	Organizatë joqeveritare
AVL	Armë të Vogla dhe të Lehta
KKSB	Këshillat komunal për siguri në bashkësi
EVSB	Ekipet vepruse për siguri në bashkësi
DAK	Departamenti i Analizës së Krimit
SIIB	Sistemi i integruar për identifikim balistik
SMRA	Sistemi për menaxhimin e regjistrimit të armëve
FireCat	Katalogu i armëve të zjarrit
AmoCat	Katalogu i municionit
ExploCon	Sistemi për kontrollin e mjeteve shpërthyes

Përkufizimet:

AVL nënkupton **armët e vogla dhe të lehta**, shprehje kjo e përdorur në protokollet për kontrollin e armëve, për t'iu referuar dy grupeve kryesore të armëve:

- **Armët e vogla:** armë zjarri të kalibrit të vogël për përdorim dore, të cilat zakonisht përbëhen nga armët e dorës, armët e gjata, “shotguns”, armët joautomatike, armët gjysmë automatike, armët automatike si dhe mitralozat portativ.
- **Armët e lehta:** përfshijnë një numër të madh të armëve të kalibrit të mesëm dhe mjeteve shpërthyesë, përfshirë raketat portative me mundësi të bartjes me dorë dhe ato me mundësi montimi në automjete kundër këmbësisë, kundërtankiste, kundërajrore, predhat, minat tokësore, mortajat, granatat e dorës, dhe tromblonet.

Rreziku për shmangie

Nënkupton rrezikun e mundshëm që armëve t’u ndërrohet rruga/destinacioni, kështu që ato nuk arrijnë në destinacionin e përcaktuar ligjor apo të cilat hyjnë në tregun kriminal.

AVL-të ilegale

Janë të gjitha AVL-të, të cilat nuk kanë bazë ligjore sipas legjislacionit të Kosovës. Kjo përfshinë armët në posedim ilegal, armët e prodhuara në mënyrë ilegale, të tregtuara në mënyrë ilegale, armët e konvertuara si dhe armët që janë riaktivizuar apo të cilave u është ndryshuar numri serik.

Ndërmjetësim

Veprimet që shërbejnë për të ndihmuar transferin e armëve në mes të personave në shtete të treta të ndryshme, deri në atë shkallë sa një transfero i tillë promovohet përmes ndihmës së ashtuquajturit **ndërmjetësues**.

Vërejtje: Aktivitetet themelore të ndërmjetësimit përfshijnë:

- a) blerjen e AVL-ve të cilat ndodhen në një shtet të tretë për qëllim të transferimit të tyre në një shtet tjetër të tretë.
- b) ndërmjetësimin në mes të shitësit dhe blerësit të AVL-ve për të ndihmuar transferimin e këtyre armëve nga një shtet i tretë në tjetrin; dhe
- c) tregimin e mundësisë shitësit apo blerësit për një transaksion të tillë (në veçanti prezantimi i shitësit dhe blerësit në kompensim për një pagesë apo shpërblim tjetër).

I.HYRJE

Kosova ka vuajtur pasojat e përhapjes së brendshme të AVL-ve në periudhën e pas luftës, ashtu si shumë prej fqinjëve të saj. Posedimi i paligjshëm i AVL-ve besohet se ka qenë prej kohësh i përhapur, dhe vlerësimet e mëparshme kanë treguar se një numër i madh i armëve të paregjistruara është në dispozicion në Kosovë¹. Pjesërisht si pasojë e kësaj, Kosova ishte prekur nga niveli i lartë i krimit të armatosur dhe gjithashtu kishte në përdorim të shpeshtë AVL-të, gjatë periudhave të tensionit. Dhuna e armatosur në Kosovë mund t'i atribuohet një numri faktorësh, duke përfshirë konfliktin dhe krimin e organizuar. E gjithë kjo ndodh kundrejt papunësisë së lartë dhe sistemit të drejtësisë penale ende në zhvillim. Pa marrë parasysh se a është rasti i civilëve të zakonshëm të cilët janë shtyrë të mbajnë armë zjarri për sigurinë e tyre, ose rasti i grupeve kriminale, qarkullimi i AVL-ve të paligjshme në Kosovë duket të jetë shkak dhe efekt i problemeve të tilla.

Strategjia e Kosovës për Kontroll dhe Grumbullim të Armëve të Vogla dhe të Lehta e propozuar këtu, është një version i ndryshuar dhe i plotësuar i Strategjisë së Kosovës për Kontroll të Armëve të Vogla, i miratuar nga qeveria më 24 prill 2008. Progresi i parë gjatë zbatimit të kornizës legislative dhe institucionale dhe kapacitetet e zhvilluara në nivelin qendror, tregojnë se është koha për të propozuar një azhurnim që përqendrohet në zbatim të mëtejshëm dhe të barabartë të kornizës së themeluar. Gjithashtu, është vlerësuar se iniciativa për dorëzim vullnetar mund të kontribuojë pozitivisht në përmirësimin e sigurisë dhe qetësisë në Kosovë.

Programi shtetëror që përqendrohet në veçanti në këtë iniciativë për dorëzim vullnetar është pjesë integrale e kësaj strategjie dhe është bashkëngjitur si aneks i këtij dokumenti.

Ky dokument, gjithashtu do të përqendrohet në sinkronizimin e mëtejshëm me strategjitë relevante të aprovuara nga qeveria, pasi që ekziston strategjia për menaxhim të integruar të kufijve dhe strategjia për parandalim të krimit.

Po ashtu, është paraparë që kjo strategji të përqendrohet tutje në kërkesat e përcaktuara nga plani i Ahtisaarit, ashtu që Kosova të ketë kontroll të plotë mbi AVL-të në pajtim me standardet e OKB-së, BE-së dhe OSBE-së dhe të udhëhiqet nga standardet Evropiane, standardet dhe kriteret e nevojshme për integrim në BE dhe procesit për liberalizim të vizave, aktualisht të diktuar nga EPAP-i.

¹ Anketa Kosova dhe armët: AVL-të ilegale llogariten në mes 310,000 dhe 440,000 armë .

II. VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është që Kosova të jetë një mjedis i sigurt, ku armët e vogla dhe të lehta të jenë nën kontroll.

Misioni

Misioni i kësaj strategjie është përcaktimi i objektivave të përgjithshme, objektivave specifike dhe aktiviteteve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me armët e vogla dhe të lehta (AVL) si dhe të harmonizojë veprimet kombëtare dhe ndërkombëtare e ndër-institucionale, për arritjen e objektivave të përcaktuara brenda strategjisë, e në veçanti të:

1. Vendoset një kornizë institucionale dhe ligjore për zbatimin e rregulloreve mbi AVL-të;
2. Reduktohet krimi me AVL dhe dhuna me armë në Kosovë;
3. Ndërpritet furnizimi me AVL dhe municion për qëllime kriminale në Kosovë;
4. Largohen armët dhe municioni ilegal tani në qarkullim në Kosovë;
5. Zvogëlohet kërkesa për AVL në shoqëri;
6. Promovohet pjesëmarrja e grave, shoqërisë civile dhe grupeve tjera në zhvillim dhe zbatim të politikave për kontroll të AVL-ve dhe strategjitë për parandalim të dhunës dhe carmatimit;
7. Zbatohet ligji dhe mbahet rendi, të kujdeset për grupet e ndjejshe dhe të mbështeten mundësitë për jetë të sigurtë dhe të qëndrueshme në komunitetet më të prekura nga dhuna;
8. Mbështetet siguria regjionale duke kontrolluar AVL-të, në mes aspekteve tjera, krimin të organizuar transnacional;
9. Zhvillohet tutje kapaciteti për zbatim të Strategjisë së Kosovës për Kontroll dhe Grumbullim të AVL-ve.

III. Metodologjia

Strategjia kombëtare për kontroll dhe grumbullim të armëve të vogla dhe të lehta, bazohet në parimet themelore që dalin nga Kushtetuta e Kosovës, legjislati i aplikueshëm, instrumentet ligjore ndërkombëtare si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Posedimi dhe përdorimi i paligjshëm i AVL-ve, është dukuri që kërkon vëmendje shtesë. Është e detyrë për të gjitha institucionet që të zbatojnë një përgjegjësi të integruar në këtë çështje, prandaj në vijë me standardet ndërkombëtare dhe si organizatë kontrolli, qeveria ka themeluar një komision kombëtar për AVL-të, i kryesuar nga kryeministri.

Si përgjegjësi e shtetit, Kosova kontribuon në luftimin ndërkombëtar kundër AVL-ve ilegale dhe do të jetë e domosdoshme që të shtohet bashkëpunimi regjional dhe ndërkombëtar për të gjurmuar armët si dhe të identifikohen kryesit e përfshirë në trafikim të AVL-ve.

Me qëllim të sigurimit të suksesit shtesë në zbatimin e kontrollit të AVL-ve, kjo strategji duhet të zbatohet në nivel qendror dhe lokal. Strategjitë për kontroll të AVL-ve nuk janë të suksesshme pa mbështetje nga qytetarët që respektojnë ligjin. Ngritja e vetëdijes së individëve dhe shoqërisë në përgjithësi mundëson vendimmarrjen dhe llogaridhënien në lidhje me keqpërdorimin e AVL-ve.

Hartimi i kësaj strategjie kombëtare përqendrohet në përkufizimin e objektivave strategjike, përgatitjen e mëtejme të kapaciteteve dhe veprimeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve që duhet të ndërmerren brenda tri viteve të ardhshme (2010-2012).

Duke parë kompleksitetin e çështjeve që lidhen me AVL-të dhe shkaqet e tyre rrënjësore, kjo strategji propozon arritjen e objektivave përmes zbatimit të aktiviteteve të ndara në 11 fusha funksionale:

- FF 1: Kontrolli dhe mbikëqyrja ndërkufitare;
- FF 2: Korniza legjislative dhe çështjet rregullative;
- FF3: Informatat, statistikat dhe hulumtimet menaxhuese;
- FF 4: Vetëdijesimi për AVL dhe strategjia për komunikim;
- FF 5: AVL, grumbullimi i municionit, materieve shpërthyes;
- FF 6: AVL, shkatërrimi i municionit, materieve shpërthyes;
- FF7: Menaxhimi i stoqeve;
- FF8: Zhvillimi i kapaciteteve;
- FF9: Zhvillimi i komuniteteve më të sigurta;
- FF 10: Monitorimi dhe vlerësimi;
- FF 11: Lidhja me reformat në sektorin e sigurisë.

Objektivat specifike për këto fusha funksionale përshkruhen tutje në këtë dokument.

IV. PARIMET E PËRGJITHSHME

Objektivat e parapara në kuadër të strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve dhe plan të veprimit, udhëhiqen nga këto parime:

4.1 Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Strategjia për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare.

4.2 Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, e në veçanti të drejtat e grave dhe fëmijëve, pa marrë parasysh origjinën etnike, gjininë, moshën dhe fenë.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë që të jetojnë në mjedis që mbrohet nga keqpërdorimi i AVL-ve.

4.3 Parimi i kujdesit shëndetësor

Trajtimi i individëve që janë viktime të dhunës me AVL, bazohet në parimet e kujdesit shëndetësor të përshkruar në Ligjin për Shëndetin e Kosovës, udhëzimet dhe protokollat në fuqi në shërbimin shëndetësor të Kosovës.

4.4 Parimi i garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për siguri dhe mbrojtje të të gjithë qytetarëve. Ky parim gjithashtu i referohet rënies së shkallës së krimit të lidhur me AVL.

4.5 Parimi i vazhdimësisë

Kërkohet përfshirje e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse e të gjitha institucioneve dhe akterëve të ndryshëm për luftim të këtij problemi.

4.6 Parimi gjithëpërfshirës

Aktualisht, keqpërdorimi i AVL-ve është çështje me të cilën përballet e tërë bota. Kjo çështje është e përhapur dhe rrezikon të gjitha nivelet e shoqërisë përfshirë komunitetin lokal, grupet, familjet dhe individët.

Parimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe mekanizmave tjerë si dhe shoqërinë në përgjithësi në përbashkëni me këtë çështje në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

4.7 Parimi i ndarjes së përvojave dhe përgjegjësisë dhe qasja e përbashkët

Ky parim ka të drejtë këmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, ndarjen e përgjegjësiwe në të gjitha nivelet, si dhe qasjen e përbashkët të adaptuar nga të gjithë akterët në kontrollimin e AVL-ve.

4.8 Parimi i të drejtës për informim

Ky parim ka të drejtën dhe obligimin për të informuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në lidhje me rreziqet dhe pasojat e përdorimit të AVL-ve.

V. MEKANIZMAT LIGJOR

Në kontrollimin e armëve të vogla dhe të lehta, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë të gjerë legjislative, ku në kuptim të legjislacionit primar, mund të përmenden, por nuk kufizohet vetëm në:

1. Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
2. Kodin Penal të Kosovës,
3. Kodin e Procedurës Penale,
4. Ligjin për Policinë,
5. Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale,
6. Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
7. Ligjin Penal për të Mitur,
8. Kodin e Doganave dhe Akcizës,
9. Ligjin për Armët,
10. Ligjin për Gjueti,
11. Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
12. Ligjin për Përdorimin Civil të Eksplozivëve,
13. Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike,
14. Ligjin për të Huajt.
15. Ligjin për Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror.

Edhe pse Kosova nuk ka nënshkruar, ratifikuar konventat dhe aktet ndërkombëtare specifike që lidhen me AVL-të, sidoqoftë aktet e saja ligjore janë mbështetur në këto instrumete ligjore ndërkombëtare:

1. Protokollin e Kombeve të Bashkuara për armë zjarri, si pjesë e protokollit të Palermos;
2. Direktiva e Këshillit 91/477/EEC e 18 qershorit 1991 mbi kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve;
3. Direktiva e Këshillit të BE 2008/51/EC që ndryshon dhe plotëson Direktivën e Këshillit të BE-së 91/477/EC;
4. Qëndrimi i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e ndërmjetësimit të armët;
5. Kodi i Mirësjelljes së BE-së mbi eksportet e armëve, 08 qershor 1998;
6. Veprimi i përbashkët i këshillit të 12 korrikut 2002 mbi kontributin e Bashkimit Evropian në luftimin e akumulimeve destabilizuese dhe përhapjen e armëve të vogla dhe të lehta dhe që shfuqizon veprimin e përbashkët 1999/34/CFSP (2002/589/CFSP).

VI. Objektivat e përgjithshme dhe lidhja me fushat funksionale:

FF	Përshkrimi	Objektivi i përgjithshëm
1	Kontrolli dhe mbikqyrja ndërkufitare	Kontrolli plotë mbi importin, eksportin dhe transitin e AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyes.
2	Korniza legjislative dhe çështjet rregullative	Zhvillimi, zbatimi dhe mbikqyrja e kornizës ligjore në linjë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim të sigurimit të kontrollit të plotë mbi AVL-të në Kosovë.
3	Informatat, statistikat dhe hulumtimet menaxhuese	Zhvillimi, zbatimi dhe mbikqyrja i një modeli për mbledhje dhe shpërndarje të informatave ndërmjet agjencioneve të zbatimit të ligjit, me qëllim të përdorimit në procesin vendimmarrës ose zhvillimit të operacioneve parandaluese/reaguese.

4	Vetëdijesimi për AVL dhe strategjia për komunikim	Të rritet përkrahja përmes informimit publik, avokimit dhe edukimit nga të gjitha grupet shoqërore për strategjinë dhe mënyrën e zbatimit.
5	AVL, Grumbullimi i municionit materieve shpërthyes	Krijimi dhe zbatimi i politikave për reduktimin e përhapjes së AVL-ve ilegale në një numër mënyrash, përfshirë legalizimin, çaktivizimin, raportimin e AVL-ve të humbura dhe gjetura, dorëzimin dhe sekuestrimin .
6	AVL, shkatërrimi i municionit materieve shpërthyes	Shkatërrimi i armëve ilegale në linjë me protokollin e OKB-së për armë zjarri dhe parandalimi i kthimit të armëve të grumbulluara prapa në tregun ilegal.
7	Menaxhimi i stokeve	Zhvillimi (hartimi) dhe zbatimi i politikave për menaxhimin e stokeve.
8	Zhvillimi i kapacitetit	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të nevojshme për rregullimin e fushës së AVL-ve dhe mekanizmave kontrollues të nevojshëm për zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit.
9	Zhvillimi i komuniteteve më të sigurta	Ngritja e përkrahjes gjithëpërfshirëse për strategjinë e kontrollit dhe grumbullimit të AVL-ve dhe veprime aktive nga qytetarët.
10	Monitorimi dhe vlerësimi	Zbatim me kohë, i saktë dhe i paanshëm i strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve.
11	Lidhja me reformat në sektorin e sigurisë	Përgjigje e integruar që do të përmirësojë sigurinë e përgjithshme në Kosovë.

6.1. FF 1. Kontrolli dhe mbikqyrja ndërkufitare

Ekzistenca e kontrolleve dhe rregulloreve në mes të shteteve që kontrollojnë qasjen e personave, mallrave dhe shërbimeve në hyrje dhe në dalje të shtetit.

Objektivi:

Kontrulli i plotë mbi importin, eksportin dhe transitin e AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyes

Objektivat specifike do të jenë:

FF 1.1. Të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave mes akterëve relevant për kontroll të kufjëve që nënkupton, policinë dhe doganat.

FF1.2. Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për import, eksport dhe transit përfshirë embargot dhe Kodin Evropian të Mirësjelljes.

FF1.3. Të rritet bashkëpunimi regional me shtetet fqinje lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me AVL-të.

FF 1.4. Bashkëpunimi me Interpolin dhe EUPOLIN lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me AVL-të.

6.2. FF 2. Korniza legjislative dhe çështjet rregullative

Parimet për kontrollin rregullativ të AVL-ve:

Masat legjislative dhe rregullative për kontroll të armëve dhe të transferimeve, duhet të jenë në pajtim me këto parime:

- a) mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe interesat e sigurisë janë të rëndësishme parësore;

- b) duhet të ruhet respektimi i politikës së jashtme shtetërore;
- c) duhet të merret certifikata legjitime për përdorimin e fundit;
- d) transferimet e propozuara duhet të jenë në pajtim me ligjin, marrëveshjet dhe ujditë përkatëse ndërkombëtare;
- e) transferimet e propozuara do t'i nënshtrohen sistemit të bazuar në kritere të vlerësimit për të përcaktuar nëse është e drejtë që të lëshohet kërkesa për licencë;
- f) ekziston baza që u siguron shteteve të drejtën për mjetet e vetëmbrojtjes përfshirë prodhimin, posedimin dhe transferimin e armëve. Sidoqoftë, shtetet gjithashtu kanë përgjegjësi për përdorim të armëve në pajtim me zotimet nën ligjin ndërkombëtar, marrëveshjet dhe iniciativat relevante politike, dhe në pajtim me legjislacionin ekzistues kombëtar;
- g) qeveria do të ruaj veto-n përfundimtare për të gjitha propozimet për prodhim, fabrikim, posedim dhe transferim të armëve, municionit dhe eksplozivëve.

Gama e legjislacionit, kontrollit dhe transferimeve të armëve

Mekanizmat rregullativ për të siguruar legjislacion efektiv për kontrollimin dhe transferimin e armëve, do të zhvillohen për të mbuluar këto fusha të përgjithshme në pajtim me praktikat më të mira:

Kontrolli i armëve (i brendshëm)

- a) përgjegjësitë dhe organizimi i legjislacionit për kontroll dhe transferim të armëve në nivel kombëtar;
- b) autoriteti kombëtar për AVL;
- c) përkufizimet e armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- d) personat e mbuluar me legjislacionin për kontroll të armëve;
- e) armët, municioni dhe eksplozivët e ndaluar;
- f) prodhimi dhe fabrikimi i armëve, municionit dhe eksplozivëve, përfshirë 'prodhimin e licencuar jashtë vendit (LPO)';
- g) armët, municioni dhe eksplozivët e pranueshëm për posedim civil;
- h) shitja e brendshme e armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- i) mekanizmat për përvetësim dhe blerje të armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- j) regjistrimi dhe licencimi i armëve, municionit dhe eksplozivëve të mbajtur nga civilët;
- k) bartja e armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- l) përdorimi legjitim i armëve, municionit dhe eksplozivëve, (përfshirë trajnimin dhe manipulimin);
- m) deponimi i sigurt i armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- n) transportimi i sigurt i armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- o) riparimi dhe modifikimi i armëve;
- p) mekanizmat për dorëzimin vullnetar të armëve, municionit dhe eksplozivëve të mbajtur nga civilët;
- q) mekanizmat për konfiskim të armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- r) sistemi kombëtar i regjistrimit të armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- s) shkatërrimi i armëve, municionit dhe eksplozivëve;
- t) kontrolli i armëve jofunksionale ose të çaktivizuara, armëve kopje, municionit dhe eksplozivëve;
- u) kontrolli i armëve, municionit dhe eksplozivëve në kuadër të sektorit të sigurisë, dhe
- v) dispozitat ndëshkimore dhe penale.

Legjislacioni për transferime (i jashtëm)

- a) përgjegjësitë, dhe organizimi i legjislacionit për kontroll dhe transferime të armëve në nivel kombëtar;
- b) autoriteti kombëtar për AVL;

- c) përkufizimet e armëve, municionit dhe eksplozivëve përfshirë pjesët e tyre;
- d) personat e mbuluar me legjislacionin për kontroll të transferimeve;
- e) armët, municioni dhe eksplozivët e ndaluar për transferim;
- f) armët, municioni dhe eksplozivët e pranueshëm për transferim;
- g) certifikimi i përdoruesit të fundit dhe verifikimi pas eksportit;
- h) mekanizmat për licencim të eksportit të armëve, municionit dhe eksplozivëve që aplikohen për fabrikuesit, shitësit dhe agjentët e transportimit që duhet të bazohen në kritere. Për shembull, kur merret parasysh një aplikacion për licencë, shtetet duhet të marrin parasysh rrezikun e devijimit për përdoruesit e palicencuar të fundit, rrezikun që armët do të përdoren për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, rrezikun ndaj sigurisë regjionale ose që do të shkatërrojë zhvillimin e qëndrueshëm;
- i) mekanizmat e licencimit për aktivitetet e ndërmjetësimit të armët, municioni dhe eksplozivët që kryhet brenda shtetit ose nga nënshtetasit kudo që gjenden (ky është dimension i jashtë-territorial);
- j) raportimi i transferimeve fizike të armëve;
- k) transiti, transferimi ose ri-eksportimi i armëve, municionit dhe eksplozivëve përmes territorit kombëtar;
- l) transportimi i sigurt i armëve, municionit dhe eksplozivëve gjatë transferimit, dhe
- m) kontrollet e transferimeve të paprekshme të teknologjisë së ndërlidhur, për shembull informatat teknike që transferohen me mjete elektronike përmes faksit ose e-mailit.

Kërkesa specifike plotësuese për transit

- a) qeveritë e transitit duhet të kërkojnë certifikimet dhe dokumentacionin për eksport dhe import respektivisht nga shteti i origjinës dhe shteti i destinacionit;
- b) certifikimet dhe dokumentacioni i tillë do t'i nënshtrohet rishikimit dhe inspektimit rigoroz ;
- c) kur ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar për parregullsi të mundshme, kontejnerët e vulosur, vagonët e trenit ose transporti rrugor, depotë doganore ose mjetet tjera siç janë mjetet e izolimit të dërgesave transit, nuk çlirojnë qeveritë e transitit nga përgjegjësia për të konfirmuar se dërgesa në fjalë është në pajtim me kërkesat ligjore, politike dhe me dokumentacion, dhe
- d) kur qeveria burimore nuk është në gjendje që të kënaqë brengat e shprehura nga qeveria e transitit në lidhje me parregullsitë e mundshme, qeveria e transitit sipas zgjedhjes, mund të refuzojë hyrjen dhe transitin, ose nëse tanimë është në transit, mundet ta kthejë ose ta mbajë dërgesën në ndonjë mënyrë tjetër.

Aftësitë për pajtueshmëri

Legjislacioni për kontroll dhe transferime të armëve do të përcaktojë;

- a) aftësinë për të raportuar për licenca para parlamentit, agjencive tjera statutare dhe opinionit të gjerë;
- b) aftësinë për të rishikuar vendimarrjen e qeverisë përmes procedurave të raportimit vjetor (përfshirë përmes debatit parlamentar);
- c) aftësinë për të kryer rishikime dhe kontrolle të mekanizmave për certifikim (për shembull garancitë e përdoruesit të fundit), licencim dhe raportim;
- d) nuk do të ketë ri-eksportim pa lejen e veçantë nga shteti burimor eksportues. Kjo duhet të vlejë jo vetëm për eksportet nga shtetet burimore në regjion por edhe kur këto shtete marrin parasysh ri-eksportimin e pajisjeve që burojnë fillimisht nga dikund tjetër;
- e) aftësinë për të ngarkuar masa detyruese (për shembull pezullim ose revokim të licencave ose certifikatave kur shkelja është e pashmangshme).

f) mekanizmat e shtrirjes në terren për të mbështetur pajtueshmërinë me ligjin, duke përfshirë:

- Publikimin e urdhrave për refuzim;
- Publikimin e ligjeve dhe rregulloreve shtesë;
- Publikimin e procedurave dhe proceseve;
- Publikimin e treguesve 'me flamur të kuq';
- Vizitat e paparalajmëruara nëpër industri, dhe
- Trajnimin, arsimimin dhe advokacinë e industrisë dhe shoqërisë civile për përgjegjësitë e tyre me ligj.

g) bashkëpunimi i qeverisë me hetuesit e OKB-së në shkeljen e embargove ndërkombëtare të armëve dhe sanksioneve tjera përkatëse, dhe

h) baza ligjore të shteteve për të përmbushur kërkesat për mekanizmat ndër-qeveritar dhe brenda-qeveritar të këmbimit të informatave.

Zbatimi

Mekanizmat zbatues në kuadër të legjislacionit për kontroll dhe transferime të armëve do të:

a) përkufizojë shkeljet;

- Angazhimi në sjellje të ndaluar;
- Shkaktimi, ndihma ose bashkëfajësia në shkelje;
- Kërkesa ose tentativa;
- Konspiracioni;
- Veprimi me vetëdije për shkelje;
- Posedimi me synim të mbajtjes, përdorimit ose transferimit ilegal;
- Keqinterpretimi dhe fshehja e fakteve;
- Evazioni;
- Dështimi për pajtueshmëri me kërkesat administrative, raportimit ose mbajtjes së regjistrave;
- Ndryshimi i licencës, dhe
- Veprimi në kundërshtim të urdhrat për pezullim të përkohshëm ose refuzim.

b) ngarkimi i masave efektive ndëshkuese dhe i ndëshkimeve përkatëse për të ndëshkuar dhe parandaluar shkeljet e mëtejme.

Objektivi:

Zhvillimi, zbatimi dhe mbikqyrja e kornizës ligjore në linjë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, me qëllim të sigurimit të kontrollit të plotë mbi AVL-të në Kosovë.

Objektivat specifike do të jenë:

FF2.1. Zhvillimi i mëtutjeshëm i kornizës legjislative, përfshirë aktet nënligjor.

FF 2.2. Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit relevant.

FF2.3. Kosova do të jetë në pajtim me instrumentet ligjore ndërkombëtare.

6.3. FF 3. Informatat, statistikat dhe hulumtimet menaxhuese

Objektivi:

Zhvillimi, zbatimi dhe mbikqyrja e mbledhjes dhe shpërndarjes së informatave ndërmjet agjencioneve të zbatimit të ligjit me qëllim të përdorimit në procesin vendimmarrës ose zhvillimit të operacioneve parandaluese/reaguese.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 3.1. Zbatimi i mëtejme i mjeteve mbështetëse.

FF 3.2. Zhvillimi i modelit të mëtejme të inteligjencës për AVL, municionit dhe materieve shpërthyes.

FF 3.3. Zbatimi i studimit për gjurmim të municionit.

FF 3.4. Zbatimi i analizave për krimet me AVL.

6.4. FF 4. Vetëdijesimi për AVL-të dhe strategjia për komunikim

Programi i aktiviteteve të ndërmarra me qëllim të përgjithshëm të zvogëlimit, dhe ku është e mundshme eliminimit, të pasojave negative të kontroleve joadekuate të AVL-ve, duke ndërmarrë një kombinim adekuat të advokacisë për AVL, arsimim për rrezikun nga AVL-të dhe operacionet e mediave/fushatat e informimit publik që bashkëpunojnë për ndryshim të sjelljeve dhe ndihmojnë zgjidhjet përkatëse alternative për periudhë të gjatë.

Objektivi:

Të rritet përkrahja përmes informimit publik, avokimit dhe edukimit nga të gjitha grupet shoqërore për strategjinë dhe mënyrën e zbatimit.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 4.1. Zbatimi i planit për vetëdijesim për AVL lidhur me kornizën legislative.

FF 4.2. Hartimi dhe zbatimi i fushatës vetëdijesuese në pajtim me programin shtetëror të grumbullimit të armëve, municionit dhe materieve shpërthyes përmes dorëzimit vullnetar.

6.5. FF 5. AVL, Grumbullimi i municionit, materieve shpërthyes

Do të thotë procesi i zbatimit të aktiviteteve për reduktuar armët ilegale nga tregu.

Objektivi:

Krijimi dhe zbatimi i politikave për reduktimin e përhapjes të AVL-ve ilegale në një numër mënyrash, përfshirë legalizimin, çaktivizimin, raportimin e AVL-ve të humbura dhe gjetura, dorëzimin dhe sekuestrimin.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 5.1. Zbatimi i grumbullimit përmes dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe materieve shpërthyes (shih aneksin).

FF 5.2. Zbatimi i Ligjit për Armët në lidhje me paaftësimin/ çaktivizimin, legalizimin dhe armët e gjetura.

FF 5.3. Zbatimi i operacioneve të konfiskimit.

6.6. FF 6. AVL, Shkatërrimi i municionit, materieve shpërthyes

Do të thotë procesi i konvertimit përfundimtar të armëve, municionit, minave dhe eksplozivëve në gjendje jofunksionale që nuk mund të funksionojnë më qëllimin që janë dizajnuar.

Objektivi:

Shkatërrimi i armëve ilegale në linjë me protokollin e OKB-së për armë zjarri dhe parandalimi i kthimit të armëve të grumbulluara prapa në tregun ilegal.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 6.1. Shkatërrimi i armëve ilegale.

FF 6.2. Shkatërrimi i municionit ilegal.

FF 6.3. Shkatërrimi i materieve shpërthyesë ilegale dhe të pasigurta.

6.7. FF 7. Menaxhimi i stokeve

Ato procedura dhe aktivitete në lidhje me sigurinë e AVL-ve në regjistrim, deponim, transportim dhe manovrim.

Objektivi:

Zhvillimi (hartimi) dhe zbatimi i politikave për menaxhimin e stokeve.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 7.1. Zbatimi dhe mbikëqyrja e kornizës ligjore mbi deponimin dhe menaxhimin të stokeve.

FF 7.2. Zbatimi i identifikimit të depove municionit dhe eksplozivëve që ka të bëjë me vendet e infrastrukturës kritike dhe depove të mallrave të rrezikshme siç janë stacionet e benzinës, etj.

6.8. FF 8. Zhvillimi i kapacitetit

Fuqia dhe aftësia që mund të ekzistojë në kuptim të njohurive, aftësive, personelit dhe resurseve për të arritur objektivat e dëshiruara.

Objektivi:

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të nevojshme për regullimin e fushës së AVL-ve dhe mekanizmave kontrollues të nevojshëm për zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 8.1. Sigurimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme për zbatimin e kornizës relevante legjislative.

FF 8.2. Trajnimi i personelit për zbatimin e iniciativës së dorëzimit vullnetar.

6.9. FF 9. Zhvillimi i komuniteteve më të sigurta

Aktivitetet i bazuar në komunë, i dizajnuar për të vendosur nevojat dhe prioritetet e grupeve të prekura në qendër të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të aktivitetëve në kontroll të AVL-ve.

Objektivi:

Ngritja e përkrahjes gjithëpërfshirëse për strategjinë e kontrollit dhe grumbullimit të AVL-ve dhe veprime aktive nga qytetarët.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 9.1. Rishikimi i strategjisë për komunitetet më të sigurta.

FF 9.2. Hapja e mëtejme e iniciativës për komunitete më të sigurta.

FF 9.3. Hapja e mëtejme e qendrave për komunitete më të sigurta.

6.10. FF 10. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi në kontekst të **kontrollit të AVL-ve**, termi i referohet vëzhgimit të autorizuar nga personeli i kualifikuar i lokacioneve, aktivitetëve ose proceseve pa marrë përgjegjësi për atë që vëzhgohet.

Kjo zakonisht kryhet për të verifikuar pajtueshmërinë me sipërmarrjet, procedurat ose praktikatat standarde dhe shpeshherë përfshinë regjistrimin dhe elementët e raportimit.

Vlerësimi është proces që tenton të përcaktojë sa më sistematikisht dhe objektivisht që është e mundur meritën ose vlerën e ndërhyrjes.

Objektivi:

Zbatim me kohë, i saktë dhe i paanshëm i strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 10.1. Zhvillimi i tabelës me pikë për monitorim dhe vlerësim.

6.11. FF 11. Lidhja me RSS

RSS është koncept dinamik për të dizajnuar strategjinë për menaxhim të funksioneve të sigurisë në mënyrë demokratike, llogaridhënëse, efikase dhe efektive për të iniciuar dhe mbështetur reformat e infrastrukturës kombëtare të sigurisë.

Objektivi:

Përgjigje e integruar që do të përmirësojë sigurinë e përgjithshme në Kosovë.

Objektivat specifike do të jenë:

FF 11.1. Integrimi i strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve në politikatat e sigurisë të Kosovës.

Aktivitetet e objektivave specifike janë të përshkruara në planin e veprimit.

VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

Mekanizmi institucional ka të bëj me rolin dhe koordinimin e aktiviteteve të cilat rrjedhin nga strategjia për kontrollin dhe grumbullimin e AVL-ve, me institucionin kryesor Ministrinë për Punë të Brendshme, përgjegjësi kjo e deleguar nga qeveria me vendimin e 23 majit të vitit 2007.

7.1. Komisioni kombëtar për AVL

Komisioni kombëtar është organ i themeluar me vendimin e qeverisë më 23 maj 2007. Për përmbushjen e detyrësive të përgjegjesive të shtetit të Kosovës lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

Komisioni kombëtar për AVL do të vazhdoj të operoj në pajtim me vendim të qeverisë.

7.2 Koordinatori kombëtar

Koordinatori kombëtar është personi përgjegjës, i mandatuar për të koordinuar, përvijuar, monitoruar dhe raportuar për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me strategjinë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve.

Koordinatori kombëtar gjithashtu funksionin si pikë fokale kombëtare për AVL për organizatat relevante ndërkombëtare.

7.3 Sekretariati

Është organ i ri me funksion që të grumbullojë informata dhe të dhëna nga institucionet tjera, të analizojë dhe vlerësojë informatat e tilla, si dhe të hartojë raporte analitike për Koordinatorin Kombëtar.

7.4 Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës

MPB-ja ka rolin funksional në arritjen e objektivave të përcaktuara brenda kësaj strategjie. Ministria përmes Policisë së Kosovës, ka autoritetin e plotë për luftimin e aktiviteteve ilegale: përdorimit, blerjes, posedimit, shitjes, shpërndarjes, importit, eksportit, përpunimit dhe prodhimit të AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyes.

Departamenti për Siguri Publike do të mbikëqyrë dhe zbatojë ligjet përkatëse për AVL dhe është organi kompetent (organi ekzekutiv) për të gjitha eksportet dhe importet në Kosovë, përfshirë individët, entitetet afariste dhe pajisjet për qëllime të veçanta. Kapaciteti i tij monitorues dhe vlerësues do të ndihmoj me rekomandime adekuate për të udhëzuar drejtimin e strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve.

Policia, së bashku me doganat e Kosovës, janë institucionet kufitare në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve ilegale për gjatë kufirit të Kosovës. Prandaj bashkëpunimi dhe koordinimi i tyre është thelbësor për përforcimin e kontrollit mbi aktivitetet ilegale që do të dëmtonte sigurinë në Kosovë.

MPB-ja dhe në veçanti Departamenti për Siguri Publike, do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, për t'u harmonizuar me Ligjin për Transportin e Materieve të Rrezikshme.

7.5. Roli i Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është pjesë e rëndësishme e strategjisë për kontrollin dhe grumbullimin e AVL-ve dhe roli i saj është që të:

- Forcojë sundimin e ligjit që të eliminojë posedimin ilegal të AVL-ve, dhe
- Kompletojë legjislacionin në fushën e sundimit të ligjit me qëllim që të ngritë efikasitetin legjislativ në arritjen e qëllimeve strategjike kundër kriminalitetit që lidhet me AVL;
- Përforcojë kapacitetet profesionale dhe teknike të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues në luftimin e të gjitha fenomeneve në burgje dhe jashtë burgjeve për personat në lirim me kusht.

7.6. Roli i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Doganat e Kosovës

Doganat e Kosovës, si agjenci e zbatimit të ligjit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, kanë rol në kontrollimin e të gjitha mallrave që hyjnë dhe dalin nga Kosova.

Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për menaxhim të integruar të kufijve siguron drejtimit që duhet të përcillen me qëllim të forcimit, bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të dy organeve kryesore në luftimin e përdorimit, tregtisë, transportit dhe prodhimit ilegal të AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyes.

7.7. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë merr pjesë në analizimin e aftësive shëndetësore për posedim të armëve në Kosovë, konform me ligjin për armë.

MSH-ja ekzekuton këto aktivitete përmes institucioneve të përcaktuara shëndetësore dhe personelit mjekësor.

MSH-ja vazhdimisht verifikon aftësitë mjekësore të poseduesve të armëve dhe njofton MPB-në kur ndonjë individ humb atë aftësi, që dëshmohet me kontroll mjekësor.

7.8. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë merr pjesë në parandalimin e përdorimit të AVL-ve përmes programeve edukativo arsimore të rregullta, duke organizuar aktivitete brenda dhe jashtë planprogrameve, ku mund të përfshihen edhe prindërit dhe komuniteti.

Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, është përgjegjëse për realizimin e programeve të rregullta dhe organizon aktivitete edhe jashtë planprogrameve, duke bashkëpunuar edhe me komitetin e prindërve të arsimit të Kosovës lidhur me fushatat e ndryshme për vetëdijësimin e të rinjve nëpër shkolla.

7.9. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Roli i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike dhe Policinë e Kosovës, kontrollon kompanitë e përfshira në tregtinë e AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyes.

7.10. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale do të bashkëpunojë me MPB-në për zbatim adekuat të Ligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve.

7.11. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të ndihmojë dhe avokojë në pjesëmarrjen e autoriteteve komunale në zbatimin e kësaj strategjie.

7.12. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, bashkëpunon me MPB-në për ekzekutimin dhe azhurnimin për stoqet ose veprimet tjera që paraqesin rrezik për mjedisin.

7.13. Zyra e Prokurorit të Kosovës

Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligjin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Zyra e Prokurorit të Kosovës do të kontribuojë në zbatimin e kësaj strategjie, duke i dhënë prioritet lëndëve që kanë të bëjnë me kryerjen të veprave penale, krimi i organizuar lidhur me tregti me armë, mbajtje në pronësi, kontroll ose përdorim të paautorizuar të armëve si dhe shitblerje të armëve.

7.14. Agjencia për Statistika e Kosovës

Agjencia për Statistika e Kosovës do të bashkëpunojë me MPB-në që të ofrojë informata statistikore për lëndimet me AVL sipas standardeve të OBSH-së.

7.15. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

MFSK do të bashkëpunojë në aktivitete në zbatim të kësaj strategjie në pajtim me kornizën ligjore.

7.16. Ministria e Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me MPB-në do të sigurojë zbatimin adekuat të embargove dhe Kodit Evropian të mirësjelljes të eksportit të armëve.

Ministria e Punëve të Jashtme, do të jetë organ ekzekutiv për miratimin dhe lëshimin e raporteve të rregullta të progresit të organizatave relevante ndërkombëtare për kontrollin e AVL-ve.

7.17. Agjencia për Inteligjencë e Kosovës

Agjencia për Inteligjencë e Kosovës, do të bashkëpunojë për zbatimin e kësaj strategjie për AVL-të që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe AVL-të si kërcnim direkt ndaj sigurisë shtetërore.

7.18. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë, është përgjegjëse për kontrollimin e armëve në posedim të rojave të pyllit si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për gjueti.

7.19. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MKRS mbështetë zbatimin e kësaj strategjie nëpërmjet zbatimit të planveprimit për rininë e Kosovës dhe zbatimi i politikave për armët në muze, zbatimi i standardeve për shoqatat e shenjtarisë.

VIII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Prodhimi, shpërndarja, konvertimi dhe përdorimi i AVL-ve janë çështje që kërkojnë bashkëpunimin e institucioneve dhe organizatave regjionale dhe ndërkombëtare, në nivel të partneritetit.

Në këtë strategji synojmë krijimin e kushteve për adresim të AVL-ve ilegale, në bashkëpunim me institucionet evropiane dhe integrimin sa më të hershëm në Bashkimin Evropian.

Në këtë rast kërkohet bashkëpunimi i dyanshëm në mes të institucioneve të Kosovës dhe institucioneve tjera ndërkombëtare të përfshira në parandalimin, luftimin dhe kontrollimin e AVL-ve.

IX. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

9.1 Roli i sistemit monitorues

Procesi i zbatimit të strategjisë do të përfshijë arritjen e objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivit dhe efikasiteti i aktiviteteve përkatëse do të përbëjë një pjesë integrale të procesit të strategjisë dhe komponentët kyç të rezultateve. Monitorimi dhe vlerësimi do të sigurojë mjetet për matje të progresit në raport me objektivat e dhëna, për të vlerësuar nevojën dhe për të caktuar drejtimin e politikave, në veçanti në lidhje me aktivitetet.

Procesi i monitorimit do të kryhet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrje të gjerë të akterëve.

Fushat kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e matjes së performancës;
- Burimet e informatës dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe shfrytëzimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

9.2 Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të mbulojë të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatim të objektivave të përcaktuara në kuadër të strategjisë dhe planit të veprimit.

- Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion udhëheqës në zbatimin e strategjisë, do të themelojë njësinë për monitorim dhe vlerësim të strategjisë nën mbikqyrjen e Koordinatorit Kombëtar të AVL-ve. Kjo njësi do të monitorojë përkundrejt treguesve më të rëndësishëm në lidhje me çështjet e AVL-ve dhe do të përgatisë raporte periodike për arritjen e progresit dhe realizimin e objektivave.
- Ministrinë e linjës do të raportojnë për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të caktuara të këtyre ministrive ose institucioneve të tyre vartëse, përfshirë edhe prokuroritë dhe gjykatat. Këto institucione do të dorëzojnë raporte periodike te koordinatori kombëtar me qëllim të sigurimit të raportimit koherent.
- Organizatat joqeveritare do të marrin pjesë në monitorim dhe vlerësim, në diskutime të përbashkëta të udhëhequr nga koordinatori. Në këto diskutime shoqëria civile do të prezantojë raportet e vëzhgimit në lidhje me projektet e implementuara nga ana e tyre.

9.3 Përzgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit final

1. Numri i ligjeve përkatëse dhe i akteve nënligjore, që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të strategjisë;
2. Strukturat e themeluara;
3. Numri i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të nënshkruara me shtetet tjera;
4. Raportet për monitorim dhe vlerësim të strategjisë,
5. Përqindja e popullsisë që është vetëdijesuar për çështjen e keqpërdorimit të AVL-ve;
6. Numri i planprogrameve dhe teksteve mësimore që adresojnë AVL-të;
7. Numri i rasteve të lidhura me AVL të trajtuara në aspektin mjekësor;
8. Numri i AVL ilegale të grumbulluara;
9. Numri i incidenteve të raportuara të dhunës me armë;
10. Mesatarja e dënimeve dhe masat shtesë të konfiskimit për kryesit e krimit përmes keqpërdorimit të AVL-ve;
11. Numri i rasteve të trajtuara nga policia, prokuroria dhe gjykatat;
12. Numri i aktiviteteve të zbatuara jashtë planprogramit.

9.4 Treguesit e ndërmjetëm

Treguesit e ndërmjetëm shfrytëzohen në monitorimin e aktiviteteve të dhëna në planin e veprimit për kontrollim të AVL-ve.

9.5 Instrumentet për monitorim e vlerësim

1. Grumbullim dhe përpunim i standardizuar i të dhënave;
2. Të dhëna administrative e statistikore nga MPB (Policia), MD, MSH, MEF (doganat, ATK), MASHT, prokuroria, gjykatat, MPMS;
3. Mekanizmat referues kombëtar dhe ndërkombëtar;
4. Anketat dhe vëzhgimet që kanë për cak vlerësimin e ngritjes së vetëdijes së popullsisë në lidhje me çështjet e AVL-ve.

9.6 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen me qëllim të shpalljes së progresit të bërë në kontrollimin dhe grumbullimin e AVL-ve. Pas hartimit të raporteve të progresit nga të

dhënat dhe vëzhgimet, ato do të shpërndahen shfrytëzuesve, të cilët përfshijnë por nuk kufizohen vetem në:

1. Institucionet qendrore dhe lokale,
2. Partnerët ndërkombëtar,
3. Shoqërinë civile,
4. Mediat,
5. Opinionin e gjerë publik.

X. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit është konform me kornizën e përgjithshme strategjike të përkufizuar me strategjinë kombëtare për kontroll dhe grumbullim të armëve të vogla.

Plani i veprimit për ekzekutimin e strategjisë do të përbëhet nga:

- Objektivat strategjike;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete me qëllim të arritjes së objektivave,
- Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e çdo aktiviteti respektivisht objektiv;
- Kornizëns kohore për arritjen e çdo aktiviteti respektivisht objektiv;
- Burimet e domosdoshme të financimit për zhvillimin e aktiviteteve respektivisht objektiv;
- Treguesit matës të caktuar përkundrejt çdo aktiviteti respektivisht objektiv.

Plani i veprimit duhet të jetë koherent me kornizën e përgjithshme të strategjisë kombëtare për kontroll dhe grumbullim të armëve të vogla dhe të lehta të Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet më relevante ndërkombëtare

Korniza ose instrumenti	Përmbledhje	Veprimi i kërkuar
Protokolli i OKB-së për armët e zjarrit ²	Ky është dokumenti i parë kryesor politik për AVL,i miratuar në OKB. Ky protokoll plotëson Konventën e OKB-së së vitit 2001 kundër krimit të organizuar transnacional. Masat e rregulluara në Protokollin e parë të OKB-së për armë zjarri përfshinë: Përforcimin e legjislacionit kombëtar, dhe Përmirësimin e këmbimit të informatave në mes qeverive për armët ilegale, tregtinë e tyre, burimet dhe rrugët e trafikimit.	Ratifikim
Programi i veprimit i OKB-së për AVL ³	Programi i veprimit i OKB-së adreson një fushëveprim më gjithëpërfshirës të AVL-ve sesa Protokolli i armëve i OKB-së dhe gjithashtu ka të bëjë me transferimet shtet-në-shtet të AVL-ve. Ai parasheh sferat e veprimit kundër AVL-ve në nivel ndërkombëtar, regjional, kombëtar dhe lokal, dhe thërret për bashkëpunim të ngushtë në mes të shteteve për të arritur qëllimet e deklaruara, përfshirë ndarjen e informatave, asistencën dhe caktimin e standardeve, dhe nënvizon rolin e organizatave regjionale që kujdesen për këtë bashkëpunim. Qeveritë janë zotuar që të takohen çdo dy vite për të ndarë informatat për zbatimin e planit të veprimit.	Antarësim

² Protokolli kundër prodhimit ilegal dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponentëve dhe municionit, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional (protokolli për armë zjarri). (Hyri në fuqi më 3 korrik 2005).

³ Programi i veprimit të Kombeve të Bashkuara për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar tregtinë ilegale me armë të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet. (Dokument i OKB-së A/CONF.192/15). Korrik 2001.

Dokumenti i OSBE-së për AVL ⁴	<p>Dokumenti i OSBE-së për AVL njih kontributin që akumulimet e AVL-ve kanë bërë në konfliktet e fundit regjionale. Ai ndanë detyrat për luftim të proliferimit dhe përhapjes së AVL-ve në disa kategori të normave dhe masave, dhe parasheh një rol potencial në zbatim për misionin e vet dhe për zyrat fushore. Këto kategori përfshijnë:</p> <p>Rregulloret kombëtare për AVL, përfshirë kontrollet e prodhimit, shënjimit dhe mbajtjes së regjistrave;</p> <p>Monitorimin dhe rregullimin e tregtisë ndërkombëtare të AVL-ve, përfshirë rregulloren e ndërmjetësimit, kriteret e përbashkëta të eksportit, kontrollet e transferimeve dhe këmbimin e informatave; dhe</p> <p>Grumbullimin e armëve, menaxhimin e stoqeve dhe shkatërrimin e tepicës – kyç për reduktim të akumulimeve destabilizuese dhe të përhapjes së pakontrolluar të armëve të vogla dhe parandalimin e trafikimit ilegal.</p>	Antarësim
Dokumenti i OSBE-së për stoqet e municionit konvencional ⁵	<p>Dokumenti i OSBE-së për stoqet e municionit konvencional është miratuar në vitin 2003 dhe plotëson dokumentin e OSBE-së për AVL. Marrëveshja përfshinë të gjitha kategoritë e municionit konvencional, materiet shpërthyes dhe mjetet detonuese, përfshirë municionin e armëve të rënda, të gjitha llojet e minave, predhat dhe mbushjet e raketave, granatat, siguresat. Dokumenti siguron procedurat praktike dhe mekanizmat për shkatërrim të këtyre stoqeve tepricë. Qëllimi final është mundësimi i shteteve pjesëmarrëse që të përforcojnë kapacitetet e tyre kombëtare ashtu që të mund të merren vet me problemet specifike, duke ndërtuar vet asetet e veta kurdo që është e mundur.</p>	Antarsim
Vendimi i OSBE-së për sistemet portative për mbrojtje ajrore (MANPADS) ⁶	<p>Vendimi i OSBE-së MANPADS adapton parimet për kontrolle të shtuara të eksportit të MANPADS, që janë nxjerrë nga Marrëveshja e Wassenaarit 'Elementet për kontroll të eksportit të sistemeve portative për mbrojtje ajrore'.</p>	Bashkim
Vendimi i OSBE-së mbi certifikatat e përdoruesit të fundit ⁷	<p>Ky vendim riafirmon zotimet e shteteve pjesëmarrëse për të vëzhguar, si një nga standardet kyçe që mbështetë dokumentacionin e eksportit, se nuk është lëshuar asnjë eksporti pa certifikatë autentike të shfrytëzuesit të fundit ose ndonjë formë tjetër të autorizimit zyrtar të lëshuar nga shteti pranues. Vendimi mbulon kërkesat e dokumentacionit dhe mekanizmave të certifikatës së</p>	Bashkim

⁴ Dokument i OSBE-së mbi armët e vogla dhe të lehta. (FSC.JOUR/314). 24 nëntor 2000

⁵ Dokument i OSBE-së mbi stoqet e municionit konvencional. (FSC.DOC/1/03). 19 nëntor 2003.

⁶ Vendimi i OSBE-së mbi sistemet portative për mbrojtje ajrore. (vendimi nr. 7/03). (FSC.DEC/07/03). 23 korrik 2003.

⁷ Vendimi i OSBE-së mbi certifikatat e përdoruesit të fundit dhe procedurat e verifikimit për eksportet e AVL-ve. (vendimi nr. 05/04). (FSC.DEC/5/04). 17 nëntor 2004.

	shfrytëzuesit të fundit.	
Vendimi i OSBE-së për ndërmjetësim ⁸	Ky vendim deklaroi parimet e dakorduara nga shtetet për të kontrolluar ndërmjetësimin të armëve me qëllim të shmangies së mashtrimit për sanksionet e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendimet e marra nga OSBE-ja, përfshirë kriteret e përcaktuara në Seksionin II A të Dokumentit të OSBE-së për AVL; marrëveshjet tjera për AVL, ose marrëveshjet tjera për kontroll të armëve dhe çarmatim, për të minimizuar rrezikun e devijimit të AVL-ve në tregjet ilegale, përveç tjerash, në duar të terroristëve dhe grupeve tjera kriminale, dhe për të forcuar kontrollin e eksportit të AVL-ve. Me qëllim të arritjes së këtyre objektivave, shtetet pjesëmarrëse do të bëjnë përpjekje për të siguruar se legjislacioni ekzistues ose i ardhshëm për ndërmjetësim të armëve është në pajtim me dispozitat e përmbajtura në këtë dokument.	Bashkim
Veprimi i përbashkët i këshillit të BE-së për AVL ⁹	BE përmes veprimit të përbashkët të saj për luftimin e akumulimeve destabilizuese dhe përhapjen e armëve të vogla, siguron asistencë financiare dhe teknike për shtetet, grupet e shteteve, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që kërkojnë mbështetje. Që nga viti 1999, përmes veprimit të përbashkët, BE ka miratuar 14 veprime të tilla në Evropën Lindore, në Amerikën Latine dhe Karaibe, në Azi dhe në Afrikë. Në mes të prioriteteve gjeografike të vendosura nga Këshilli Evropian, vëmendje të veçantë i është kushtuar shkatërrimit të stoqeve ekzistuese të AVL-ve në Evropën lindore dhe juglindore, dhe veprimeve në mbështetje të moratoriumeve regjionale për armët e vogla në Afrikë.	Bashkim
Kodi i Mirësjelljes i BE-së mbi eksportet e armëve ¹⁰	Kodi i Mirësjelljes i BE-së përfaqëson një model për kontrollin e eksporteve konvencionale ushtarake, që u paraqit nga Bashkimi Evropian si zotim politik në vitin 1998. Ai vendos kriteret për miratim të eksporteve dhe parasheh dispozitat e transparencës siç është publikimi i një raporti vjetor që i jep shoqërisë civile si dhe komunitetit zyrtar një mjet për të vlerësuar performancën e shteteve individuale. Kodi i Mirësjelljes i BE-së është duke iu nënshtruar rishikimit të tij të parë duke synuar që të bëhet Qëndrimi i Përbashkët e BE-së me obligim ligjor.	Bashkim
Strategjia e BE-së për të luftuar akumulimin dhe trafikimin	Më 16 dhjetor 2005, Këshilli i Evropës miratoi Strategjinë për të mbështetur veprimin e përbashkët për AVL të vitit 2002 (2002/589/CFSP). Strategjia është shkruar në kuadër të kornizës së Strategjisë Evropiane për Siguri (2003), siç ishte strategjia e ngjashme për armët e shkatërrimit në	Bashkim

⁸ Vendimi i OSBE-së mbi parimet për kontroll të ndërmjetësimin të AVL-tç. (vendimi nr. 08/04). (FSC.DEC/8/04). 24 nëntor 2004.

⁹ Veprimi i përbashkët i këshillit të BE-së mbi kontributin e Bashkimit Evropian në luftimin e akumulimeve destabilizuese dhe përhapjen e armëve të vogla dhe të lehta dhe që shfuqizon Veprimin e Përbashkët 1999/34/CFSP. (2002/589/CFSP). 12 korrik 2002.

¹⁰ Kodi i Mirësjelljes së BE-së mbi eksportet e armëve, 8 qershor 1998.

ilegal të AVL-ve dhe municionit të tyre ¹¹	masë në vitin 2003. Me këtë synohet zhvillimi i një <i>“qasjeje të integruar dhe një plan gjithëpërfshirës për të luftuar tregtinë ilegale me AVL dhe municionin e tyre”</i> .	
Qëndrimi i përbashkët e BE-së mbi ndërmjetësimin te armët ¹²	Objektivi i Qëndrimit të Përbashkët është kontrollimi i ndërmjetësimin te armët me qëllim që t’i shmanget mashtrimeve te embargot e armëve nga OKB, BE ose OSBE si dhe të kritereve të përcaktuara në Kodin e Mirësjelljes së BE-së. Ai obligon shtetet anëtare të BE-së që të vendosin korniza të qarta ligjore për aktivitetet e ndërmjetësimin. Pjesë e kësaj kornize është sistemi i licencimit ku aplikacionet për licencë vlerësohen për transaksione specifike të ndërmjetësimin përkundrejt dispozitave të Kodit të Mirësjelljes së BE-së. Qëndrimi i përbashkët gjithashtu parasheh themelimin e një mekanizmi për këmbim të informatave për aktivitetet e ndërmjetësimin.	Bashkim
Zbatimi regjional për AVL i Paktit të Stabilitetit ¹³	Në nëntor 2001 Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (SCSP) ¹⁶ prodhoi planin zbatues regjional (PS AVL PZR) për të luftuar proliferimin e pakontrolluar të armëve të vogla dhe të lehta (AVL). Ky plan u rishikua në maj 2006. Për dallim nga shumë marrëveshje tjera të kontrollit të armëve, PS AVL PZR ofroi mekanizma konkret për të ndihmuar zbatimin e zotimit të vendeve dhe përfshirjen e atyre qeverive në caktimin e prioriteteve dhe në vendimmarrje në përpjekjet mbarë regjionale. Këto mekanizma mbështeten ose zbatohen përmes SEESAC-ut në nivel regjional, dhe përmes një sërë iniciativash të mbështetura ndërkombëtarisht brenda shteteve individuale. Në nivel politik, PS AVL PZR duhet të konsiderohet sukses, dhe ka ofruar mandat të vlefshëm dhe efektiv për të ngarë një përgjigje efektive në nivel operativ.	Bashkim

¹¹ Strategjia e BE-së për të luftuar akumulimin dhe trafikimin ilegal të AVL-ve dhe municionit të tyre. Këshilli i Bashkimit Evropian 5319/06 i 13 janarit 2006. (e miratuar më 15 - 16 dhjetor 2005).

¹² Qëndrimi i përbashkët e BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e ndërmjetësimin te armët. OJ L 156, 25.05.2003, f. 79-80.

¹³ Luftimi i proliferimit të AVL-ve – Plani regjional për zbatim të paktit të stabilitetit për Evropën Juglindore, 28 nëntor 2001. (i rishikuar në maj 2006). (www.stabilitypact.org).

Plani i veprimit

FF Objektivat strategjikë	Objektivat specifike	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetese	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
1 Kontrolli i plotë mbi importin, eksportin dhe transitin e AVL-ve, municionit dhe materieve shpërthyesë	FF1.1. Të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi informativë mes akterëve relevant për kontroll të kufirit që nënkupton, policinë dhe doganat.	FF1.1.1. Implementimi i SMRA në pikat kufitare.	MPB Policia Doganat	2010	Donacion i paguar	Softweri i Instaluar
		FF1.1.2. Harmonizimi i procedurave ekzistuese në pajtim me procedurat aktuale të kapitullit 7 Shenghen.	Policia Doganat	2010	Kosto administrative	Procedurat e harmonizuara dhe miratuara
		FF1.1.3. Të sinkronizohen PSO mes dy institucioneve.	Policia Doganat	2010	Kosto administrative	Procedurat e harmonizuara dhe miratuara
	FF1.2. Zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për import, eksport dhe transit, përfshirë embargot dhe Kodin Evropian të Mirësjelljes	FF 1.2.1. Të krijohet studim rasti për zbatimin e Kodit Evropian të Mirësjelljes.	MPB MPJ KIA	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Raporti mbi studimin e rastit
	FF1.3. Të rritet bashkëpunimi regional me shtetet fqinje lidhur me çështjet që	1.3.1. Organizimi i dy konferencave të nivelit rajonal lidhur me AVL. 1.3.2. Krijimi i	MPB MPJ	2010-2011	20.000	Konferencat e organizuara Takimet e

	kanë të bëjnë me AVL.	komunikimit të drejtëpërdrejtë për qeshtjet e AVL-ve.	MPB MPJ	Në vazhdimësi	Kosto administrative	realizuara
	FF 1.4. Bashkëpunimi me Interpolin dhe EUPOLin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me AVL	1.4.1. Shkëmbimi i informacioneve. 1.4.2. Prezentime të mekanizmave policor ndërkombëtar.	Policia e Kosovës MPB PK	Në vazhdimësi Në vazhdimësi	Kosto administrative Kosto administrative	Bashkëpunimi i realizuar Shpërndarja e informatave

Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitetet	Institucione t përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
<p>2</p> <p>Zhvillimi, zbatimi dhe mbikqyrja e kornizës ligjore në linjë me standardet ndërkombëtar e dhe evropiane me qëllim të sigurimit të kontrollit të plotë mbi AVL-të në Kosovë.</p>	FF2.1. Zhvillimi i metutjeshëm i kornizës legjislativë, përfshirë aktet nënligjore	FF 2.1.1. Miratimi i akteve në ligjore për zbatimin e ligjit për armët	MPB	2010	Nuk ka	Të miratuara
		FF 2.1.2. Miratimi i Ligjit për Industrinë e Sigurisë Private (IPS) dhe hartimi si dhe miratimi i akteve në ligjore të ligjit për IPS	Kuvendi i Kosovës dhe MPB	2010	Nuk ka	Të miratuara
		FF 2.1.3. Miratimi i Ligjit për Pajisje për Qëllime të Veçanta (PQV) dhe hartimi si dhe miratimi i akteve nënligjor të ligjit për PQV.	Kuvendi i Kosovës dhe MPB	2010	Nuk ka	Të miratuara
		FF 2.1.4. Amandamentim i i Ligjit për Gjueti.	MPBZHR	2010	Nuk ka	Të miratuara
		FF 2.1.5. Miratimi i Projekt ligjit për plotësim ndryshimin e ligjit për përdorim civil të eksplozivëve, dhe miratimi i akteve në ligjore të këtij ligji.	Kuvendi i Kosovës MPB	2010	Nuk ka	Të miratuara
		FF 2.1.6. Futja në strategjinë legjislativë për vitin 2010 si dhe miratimi i Ligjit për dorëzim vullnetar dhe hartimi si dhe miratimi i akteve në	Kuvendi i Kosovës, MPB, MD	2009-2010	Nuk ka	Të miratuara

		ligjore të ligjit për dorëzim vullnetar.				
	FF 2.2. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit relevant	FF 2.2.1. Inspektimi i zbatimit të legjislacionit aktual.	MPB	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Raportet nga Inspektimet kryera
		FF 2.2.2. Zbatimi i mjeteve mbështetëse (IBIS, WRMS, FireCat, AmmoCat dhe ExploCon).	MPB PK	2010	2 milion te paguara nga KE dhe UNDP	Mjetet mbështetëse janë funksionale.
	FF2.3. Kosova do të jetë në pajtim me instrumentet ligjore ndërkombëtare	2.3.1. Propozime në ZKM për marrëveshjet relevante	MPB ZKM MPJ	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Në pajtim me marrëveshjet

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucione t përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
3 Zhvillimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e mbledhjes dhe shpërndarjes së informatave ndërmjet agjencioneve të zbatimit të ligjit me qëllim të përdorimit në procesin vendimmarrës ose zhvillimit të operacioneve parandaluese/reaguese	<u>FF 3.1.</u> <u>Zbatimi i mëtejshëm i mjeteve mbështetëse</u>	FA3.1.1. Integrimi i SMRA në sistemin informativ menaxhues.	MPB, PK, Dogana	2010	Nuk ka	Sistemi i integruar
		FA3.1.2. Integrimi i ExploCon systemin informativ menaxhues.	MPB, DSP, PK, KPMM	2010	Nuk ka	Sistemi i integruar
		FA3.1.2. Integrimi i IBIS systemin informativ menaxhues.	MPB, PK, Gjykatat	2010	Nuk ka	Sistemi i integruar
	<u>FF 3.2.</u> <u>Zhvillimi i modelit të mëtejshëm të inteligjencës për AVL, municion dhe materie shpërthyes</u>	FA3.2.1. Rishikimi i procedurave ekzistuese.	MPB PK	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Procedurat e rishikuara
	<u>FF 3.3.</u> <u>Zbatimi i studimit për gjurmim të municionit</u>	FF3.3.1. Trajnim i laboratorit forenzik lidhur me gjurmimin dhe zbatimin e modelit për gjurmim	MPB	2010	Nuk ka	Laboratori I forensikes I integruar dhe I trajnuar
	<u>FF 3.4.</u> <u>Zbatimi i analizave për krimet me AVL.</u>	FF3.3.2. <u>Hartimi i raporteve periodike analitike për krimet me AVL.</u>	PK-DAK	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Raportet e hartuara

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
<p>4</p> <p>Të rritet përkrahja përmes informimit publik, avokimit dhe edukimit nga të gjitha grupet shoqërore për strategjinë dhe mënyrën e zbatimit.</p>	<p><u>FF 4.1. Zbatimi i planit për vetëdijesim për AVL lidhur me kornizën legjislative</u></p>	<p>FA4.1.1. Te rifreskohen faqet e internetit per parandalimin e krimit dhe informatat shtese ne lidhje me legjislacionin ne fuqi.</p>	<p>MPB, MAP</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Kosto administrative</p>	<p>Rifreskimi (azhurimi) i Faqevete Internetit</p>
		<p>FA4.1.2. Informimi dhe vetëdijesimi i publikut për ligjet relevante në nivelin lokal dhe qendror.</p>	<p>MPB, KKSP,EVSB, Shoqëria Civile dhe OJQ të Specializuara</p>	<p>2010</p>	<p>100 000 te ofruara nga UNDP</p>	<p>Realizimi i fushatës</p>
	<p><u>FF 4.2. Hartimi dhe zbatimi i fushatës vetëdijesuese në pajtim me Programin Shtetëror të grumbullimit të armëve, municionit dhe materieve shpërthyesë përmes dorëzimit vullnetar.</u></p>	<p>Shikoni shtojcën.</p>				

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
<p>5</p> <p>Krijimi dhe zbatimi i politikave për reduktimin e përhapjes së AVL-ve ilegale në një numër mënyrash, përfshirë legalizimin, çaktivizimin, raportimin e AVL-ve të humbura dhe të gjetura, dorëzimin dhe sekuestrimin .</p>	<u>FF 5.1. Zbatimi i grumbullimit përmes dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe materieve shpërthyes (shih aneksin.)</u>	Shikoni shtojcë.				
	<u>FF 5.2. Zbatimi i ligjit për armët në lidhje me paaftesimin/ çaktivizimin, legalizimin dhe armët e gjetura.</u>	FA 5.2.1. Hartimi i procedurave për çaktivizim.	MPB	2010	Kosto administrative	Procedurat e miratuara Numri i armëve të çaktivizuara.
		FA 5.2.2. Hartimi i procedurave për legalizim.	MPB	2010	Kosto administrative	Procedurat e miratuara Numri i armëve të legalizuara.
		FA 5.2.3. Hartimi i procedurave për armë të gjetura.	MPB	2010	Kosto administrative	Procedurat e miratuara Numri i armëve të humbura dhe gjetura
	<u>FF 5.3. Zbatimi i operacioneve të konfiskimit</u>	FA 5.3. 1 Përdorimi i të dhënave inteligjente për operacionet mbi stoqet ilegale.	AKL, PK/DAK	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Operacionet e realizuara mbi bazën e të dhënave Numri i armëve të konfiskuara
		FA 5.3.2 Paisja e njësitit K9 pranë PK-së me qentë shtesë për detektimin e municionit dhe mjeteve shpërthyes.	PK	Në vazhdimësi	PK/Donacion	K9 është i pajisur dhe funksionon
	FA 5.3.3. Zbatimi i veprimeve kundër armëve të konvertuara. Zbatimi i <i>intelligence led operations</i> në bazë të analizave detaje për armë të konvertuara.	PK Dogana	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i armëve të gjetura	

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
6 Shkatërrimi i armëve ilegale në linjë me protokollin e OKB-së për armë zjarri dhe parandalimi i kthimit të armëve të grumbulluara prapa në tregun ilegal.	<u>FF 6.1.</u> <u>Shkatërrimi i</u> <u>armëve ilegale</u>	Përpilimi i procedurave standarde për shkatërrimin e armëve. Caktimi i vendeve ku do të shkatërrohen armët.	MPB PK MPB MMPH MAPL PK	K1 2010 K2 2010	Kosto administrative Kosto administrative	Procedurat për shkatërrimin e armëve të miratuara Vendet e caktuara
	<u>FF 6.2.</u> <u>Shkatërrimi i</u> <u>municionit</u> <u>ilegal</u>	FF 6.1.1. Organizimi i ngjarjeve publike të shkatërrimit të AVL-ve.	MPB Gjykatat dhe prokuroria MFSK	Në vazhdimësi	50,000 (kontribut nga donatorët)	Numri i armëve të shkatërruara. Verifikimi i evidencës.
	<u>FF 6.3.</u> <u>Shkatërrimi i</u> <u>materieve</u> <u>shpërthyes</u> <u>ilegale dhe të</u> <u>pasigurta</u>	Përpilimi i procedurave standarde për shkatërrimin e municionit ilegal dhe materieve shpërthyes.	MPB PK MPB Gjykatat dhe Prokuroria MFSK	K1 2010 Në vazhdimësi	Kosto administrative Nuk ka	Procedurat për shkatërrimin e municionit ilegal materieve shpërthyes të miratuara
		FF 6.1.2. Organizimi i ngjarjeve për shkatërrimin e municionit ilegal dhe materieve shpërthyes.				

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
7 Zhvillimi (hartimi) dhe zbatimi i politikave për menaxhimin e stoqeve.	<u>FF 7.1.</u> <u>Zbatimi dhe</u> <u>mbikëqyrja e</u> <u>kornizës ligjore</u> <u>mbi deponim</u> <u>dhe menaxhim</u> <u>të stoqeve</u>	FA 7.1.1. Hartimi, miratimi dhe publikimi i standardeve të Kosovës për deponimin e armëve, municionit dhe materieve shpërthyes.	MPB MTI/agjencia për standardizim MFSK	K2 2010	Nuk ka	Standardet e Kosovës për deponimin e armëve, municionit dhe materieve shpërthyes të miratuara.
		FA 7.1.2. Zbatimi dhe kontrollimi i depove për arme, municion dhe materie shpërthyes.	MPB PK KIA MD/SHKK MBPZHR/Agjencioni i pyjeve MEF/Dogana MKRS/muzeumet MTI/Agjencia për standardizim MFSK	Në vazhdimësi	E mbuluar me buxhetin e ligjit për PQV dhe ligji për armë	Raportet e inspektimit të rregullt të depove
		FA 7.1.3. Të sigurohet përfshirja e masave emergjente që dalin nga municioni apo mjetet shpërthyes në ligjin për parandalim të zjarrit.	MPB/Departamenti për emergjencë në bashkëpunim me zyrën ligjore	K2 2010	E mbuluar me Buxhetin te parapamë me ligjet relevante	Ligji për parandalim nga zjarri
	<u>FF 7.2.</u> <u>Zbatimi</u> <u>identifikimit i</u> <u>depove e</u> <u>municionit dhe</u> <u>eksplozivëve,që</u> <u>ka të bëjë me</u> <u>vendet e</u> <u>infrastrukturës</u> <u>kritike dhe</u> <u>depove të</u> <u>mallrave të</u> <u>rrezikshme sic</u> <u>janë stacionet</u> <u>e benzinës, etj.</u>	7.2.1. Identifikimi i depove të mallrave të rrezikshme dhe sinkronizimi i analizave me procedurat e licencimit.	MPB MTI MFSK MME MMPH MTPT MEF/Dogana PK MAPL Si dhe institucionet tjera relevante	K4 2010	20000	Harta e zhvilluar dhe azhurnuar

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
8 Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të nevojshme për regullimin e fushës së AVL-ve dhe mekanizmeve kontrollues të nevojshëm për zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit.(të diskutohet)	<u>FF 8.1.</u> <u>Sigurimi i burimeve njerzore te mjaftushme per zbatimin e kornizës relevante legislative</u>	8.1.1. Delegimi i përfaqesuesve nga institucionet përgjegjëse. 8.1.2. Trajnimi i personelit në lidhje me dokumentet mbështetëse/relevante .	MPB/Departament i për Siguri Publike MPB MFSK Partneret nderkombetar	K1 2010 2010/Në vazhdimësi	Kosto administrative Donacion	Listën e përfaqësuesve nga ministrinë Personeli i trajnuar
	<u>FF 8.2.</u> <u>Trajnimi i personelit për zbatimin e iniciativës së dorëzimit vullnetar.</u>	Shikoni shtojcën				1 milion

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucione t përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
<p>9</p> <p>Ngritja e përkrahjes gjithëpërfshirë se për strategjinë e kontrollit dhe grumbullimit të AVL-ve dhe veprime aktive nga qytetarët.</p>	<u>FF 9.1. Rishikimi i strategjisë për komunitete t më të sigurta</u>	FA9.1.1. Themelimi i grupit punus	MPB PK Grupi punues i Kosovës për veprime policore të bazuara në komunitet MAPL	K3 2010	Kosto administrative	Grupet e themeluara
		FA9.1.2. Hartimi dhe miratimi i strategjisë për sigurinë e komuniteteve.	MPB PK Grupi punues i Kosovës për veprime policore të bazuara në komunitet MAPL	K3 2010	Kosto administrative	Strategjia e miratuar
	<u>FF 9.2. Hapja e mëtejme e iniciativës për komunitete më të sigurta</u>	FA9. 2.1 Shpërndarja/krijimi e/i iniciativës për siguri të komuniteteve në komuna	MPB PK Grupi punues i Kosovës për veprime policore të bazuara në komunitet MAPL Qeverisja lokale	2010/ne vazhdimi	Donatorët	Miratimi i planeve të komuniteteve Raport i ndërmjetem nga komunat
<u>FF 9.3. Hapja e mëtejme e qendrave për komunitete më të sigurta</u>	FA9. 3.1 Themelimi i qendrave për siguri të komuniteteve në komuna	MPB PK Grupi punues i Kosovës për veprime policore të bazuara në komunitet MAPL Qeverisja lokale	2010/ne vazhdimi	Donatorët	Qendrat në komunitete të themeluara dhe operative	

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
10 Zbatim me kohë, i saktë dhe i paanshëm i strategjisë për kontroll dhe grumbullim të AVL-ve.	<u>FF 10.1.</u> <u>Zhvillimi i</u> <u>tabelës me pikë</u> <u>për monitorim</u> <u>dhe vlerësim</u>	10.1.1. Formulo metodologjinë dhe versionin e tabelës. 10.1.2. Të shpërndahet tek institucioet dhe të trajnohet personeli. Të hartohen mekanizma raportues (OSBE)	MPB	2010	Kosto administrative	Ekziston metodologjia e punës dhe raportimi

FA Objektivat strategjike	Objektivat specifike	Aktivitet	Institucionet përgjegjëse dhe mbeshtetese	Afati kohor	Implikimet buxhetore (Euro)	Treguesit
11 Përgjigje e integruar që do të përmirësojë sigurinë e përgjithshme në Kosovë	<u>FF 11.1.</u> <u>Integrimi i</u> <u>strategjisë</u> <u>për kontroll</u> <u>dhe</u> <u>grumbullim</u> <u>të AVL-ve në</u> <u>politikat e</u> <u>sigurisë të</u> <u>Kosovës.</u>	Grupi i punes për sinkronizim të strategjive.	Sekretaria e këshillit nacional për siguri.	Në vazhdimsi	Kosto administrative	AVL e integruar ne Politikat e sigurise te Kosoves



Republika e Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme

PROGRAMI I KOSOVËS

Për përmirësimin e sigurisë publike përmes dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe të mjeteve eksplozive, i quajtur Siguria për Zhvillim (më tej në tekst: Programi i Kosovës)

Tetor 2009

Hyrje

1.1. Nevoja për strategjinë e grumbullimit të armëve të vogla dhe të lehta

Posedimi i paligjshëm i armëve në Kosovë ka qenë më i dukshëm në Republikën e Kosovës përmes përdorimit të tyre gjatë kryerjes së krimeve të ndryshme. Kjo është vërtetuar përmes analizave dhe konfirmimit nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës, për numrin e veprave penale në këtë fushë, si dhe përmes konfiskimit të armëve, municionit dhe të mjeteve eksplozive të paligjshme. Një fakt edhe më alarmues është se ato kohëve të fundit gjithashtu po përdoren nga bandat e të rinjve dhe në shkaktimin e dhunës nëpër shkolla.

Kjo gjendje është si rrjedhojë e një numri zhvillimesh të pafavorshme ekonomike, politike dhe të sigurisë në Ballkan, të cilat kryesisht ndodhen mes viteve 1990 dhe 2000. Posedimi i armëve është i lidhur me konfliktin e armatosur në Kosovë dhe me mbetjen e një numri të armëve pas përfundimit të saj. Po kështu, armët janë blerë dhe poseduar për mbrojtje personale, të pronës dhe të familjes gjatë periudhës së tranzicionit.

Nismat e ngjashme paraprake në Kosovë, të zbatuara nga organizatat ndërkombëtare kanë pasur sukses të kufizuar, kryesisht për shkak të mospërfshirjes së institucioneve qeveritare të Kosovës.

Zbatimi i dorëzimit të organizuar dhe vullnetar të armëve, të udhëhequr nga institucionet e Qeverisë së Kosovës, është i nxitur më tej nga proceset e integriteteve euro-atlantike, por ka për qëllim edhe ndryshimin e imazhit të Kosovës. Kosova është e përcaktuar të jetë në përputhje me standardet e BE-

së, OSBE-së dhe të OKB-së lidhur me posedimin e armëve nga civilët. Në vazhden e këtyre aktiviteteve janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi korniza e re legjislative dhe Strategjia për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL). Për më tepër, zbatimi i kësaj nisme do të jetë në funksion të parandalimit të përdorimit të armëve kundër qytetarëve të Kosovës, dhe do t'i kontribuonte më tej stabilitetit të përgjithshëm.

Duke i shqyrtuar modalitetet e zbatimit të këtij procesi, dhe duke marrë parasysh njëkohësisht zhvillimet, nevojat dhe mundësitë e tanishme të shtetit, si dhe vlerësimin për suksesin e procesit, Qeveria e Kosovës ka vendosur të zbatojë një strategji mbarëkosovare, të bazuar në Udhëzimin administrativ të ligjit për armët, dhe të zbatojë modelin e dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe të materialeve eksplozive në një periudhë të paracaktuar, pa i identifikuar pronarët e armëve. Kjo nënkupton lirin nga ndjekja penale për veprat që paraqesin vepra penale apo vepra të tjera të dënueshme.

Qeveria do të kërkojë ndihmesë nga misioni i KFOR-it për vendosje në depo mjetet e grumbulluara, do të kërkojë këshilla teknike nga projekti KOSSAC i UNDP-së, si dhe një mision vëzhgues nga organizatat ndërkombëtare (OSBE-ja, EULEX-i, UNMIK-u dhe nga misionet diplomatike).

Aktivitetet e planifikuara janë pjesë përbërëse e Strategjisë së Kosovës për AVL-të, ku do të përdoret modeli: “Armët në këmbim të stimulimeve”.

I. Historiku

Që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999, KFOR-i dhe policia kanë marrë AVL-të nga shoqëria e Kosovës përmes konfiskimeve dhe grumbullimit. Deri më tani janë organizuar disa periudha të amnistive në vitet 2001, 2002, dhe 2003, gjatë të cilave AVL-të e paligjshme kanë mundur t'i dorëzohen vullnetarisht KFOR-it dhe policisë. Siç tregon edhe tabela më poshtë, rezultatet e amnistisë dhe të fushatave të grumbullimit janë të dobëta në krahasim me numrin e vlerësuar të armëve të paregjistruara në Kosovë. Veçanërisht, fushata e grumbullimit të armëve e vitit 2003, e organizuar së bashku nga UNDP-ja, UNMIK-u dhe KFOR-i, ka qëndruar dobët në këtë aspekt.

Data	Armët e zjarrit	Municioni	Akterët
21 qershor – 19 shtator 1999	9,978	5,000.000	KFOR-i
01 maj – 03 qershor 2001	777	31,000	UNMIK-u – KFOR-i
15 mars – 15 prill 2002	496	59,200	UNMIK-u – KFOR-i
01 – 30 shtator 2003	155		UNDP-ja – UNMIK-u – KFOR-i

Nisma e fundit ka shënuar shifrat më të ulëta nga të gjitha nismat e tjera paraprake, por duhet të ceket se gjatë të njëjtës periudhë janë legalizuar dhe regjistruar mbi 33.000 armë.
,0

Historiku i grumbullimit të armëve në Kosovë:

1. Amnistitë janë organizuar së bashku nga KFOR-i dhe UNMIK-u. Përmes tyre, njerëzit kanë mundur t'ia dorëzojnë armët në mënyrë anonime qoftë policisë apo KFOR-it. Për këtë qëllim, janë caktuar vendet e posaçme të dorëzimit. Gjatë amnistisë së dytë, më shumë se 80% të armëve janë grumbulluar nga KFOR-i, i cili ka pasur mjete dhe burime organizative më të mira për zbatimin e amnistisë. Përveç armëve të dorëzuara, autoritetet vërejtjen gjatë amnistisë se ka pasur më shumë 'gjetje të rastësishme' të armëve. Kjo duket se tregon se njerëzit që nuk i kanë besuar premtimit të autoriteteve i kanë lënë armët në vendet ku KFOR-i apo UNMIK-u me siguri do t'i gjente.

2. Programet e organizuara të grumbullimit të armëve në Kosovë kanë një historik të gjatë dhe të vështirë.

Konfiskimet janë bërë që nga kohërat e Perandorisë Osmane. Në vitin 1844, në kuadër të një reforme, pushteti i Portës së Lartë në Stamboll filloi të fuqizojë kontrollin e tij mbi regjionet si Kosova, që më parë kontrolloheshin nga distanca. Këto masa të reja, po ashtu përfshinin tentimet për çarmatosjen e popullatës vendore. Pasi që reforma hasi në rezistencë në Kosovën konservative, gjatë dekadave vijuese janë konfiskuar më shumë armë gjatë fushatave të njëpasnjëshme për mbajtjen e popullatës nën kontroll. Një nga arsytet se pse të ashtuquajturit revolucionarët xhonturk morën përkrahjen e shqiptarëve konservativë në Kosovë, në përpjekjet e tyre për marrjen e pushtetit nga strukturat e vjetra të pushtetit në Stamboll, ishte se ata premtuan se do t'i respektonin zakonet tradicionale shqiptare, duke përfshirë edhe atë për mbajtjen e armëve.

Në dekadën e parë të shekullit të njëzet, popullata e Kosovës prapë ia filloi kryengritjes kundër osmanëve; kësaj radhe për shkak të futjes së tatimeve të reja. Për ta shtypur rezistencën, trupat osmane u dërguan në Pejë dhe në Gjakovë, ku tatimet u volën me forcë, popullata u regjistrua dhe armët u konfiskuan. Për shembull, në vitin 1910, thuhet se janë

konfiskuar me forcë një numër i madh i armëve prej 147,525 sosh. Njëkohësisht, janë ndaluar të gjitha llojet e thikave, përveç thikave të bukës.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit njëzet, kur shqiptarët ishin nën sundimin serb/jugosllav, xhandarmëria serbe zbatoi, siç i quajti, ekspeditat e çarmatimit, por të cilat në fakt u përshkallëzuan në dhunë sistematike etnike kundër shqiptarëve. Në fillimvitet e pasluftës së dytë botërore, policia federale e Jugosllavisë, e udhëhequr nga ministri i punëve të brendshme, Aleksandër Rankoviqi, tentoi që armët t'i merrte me dhunë nga popullata. Në dimrin e vitit 1956, këto konfiskime të bëra shtëpi më shtëpi çuan në rrahje, tortura dhe madje edhe në vrasje. Në bazë të Noel Mallkollmit 'trajtimi i atyre që nuk dorëzonin armët ishte aq i keq, sa që shumë shqiptarë u desh të blinin armën në mënyrë që më pastaj ta dorëzonin' (1998, f. 320–21).

Pas shkatërrimit të federatës jugosllave në vitet 1990-ta, Millosheviqi vazhdoi traditën e grumbullimit të dhunshëm të armëve. Shqiptarët e Kosovës rriheshin, torturoheshin apo gjobiteshin pa të drejtë gjatë operacioneve për konfiskimin e armëve.

Burimet: Mallkollm (1998); Jansen (2002)

Mësimet e nxjerra nga nismat e mëparshme të zbatuara:

1. Dy amnistitë e para janë organizuar së bashku nga KFOR-i dhe UNMIK-u. Ato u kanë mundësuar njerëzve që armët e tyre t'i dorëzojnë në mënyrë anonime qoftë në polici apo në KFOR, ku janë caktuar pika të posaçme të dorëzimit. Gjatë amnistisë së dytë, më shumë se 80% të armëve janë grumbulluar nga KFOR-i, i cili kishte mjete organizative dhe burime më të mira për zbatimin e amnistisë. Përveç armëve të dorëzuara, autoritetet vërejtën se ka pasur më shumë 'gjetje të rastësishme' të armëve gjatë periudhës së amnistisë. Kjo duket se tregon se njerëzit që nuk u besonin premtimit të autoriteteve për anonimitet i lanë armët në vendet ku KFOR-i apo policia e UNMIK-ut kishte gjasa që t'i gjenin;
2. Amnistia e tretë është zbatuar së bashku nga UNDP-ja, KFOR-i dhe UNMIK-u, dhe është bazuar në qasjen "armët për zhvillim", e cila në praktikë donte të thoshte se komunitete apo komunat do të shpërbleheshin nëse do të mund të grumbullonin një numër të mjaftueshëm të armëve. Nisma nuk pat sukses për shkak se në njërin anë kontributet e donatorëve ishin shumë të mëdha në atë moment dhe se armët mbahen individualisht e jo në nivel të komunitetit, nga ana tjetër;
3. Gjatë këtyre nismave mungonin po ashtu edhe informatat eksplicite në nivelin bazë se çka në fakt duhet të bëhej dhe ku;
4. Besimi në institucionet organizuese nuk ishte i mjaftueshëm;
5. Nuk kishte përkrahje të mjaftueshme nga udhëheqësit politikë, dhe transparenca nuk u promovua sa duhet;
6. Ekzistonte ndjenja e çarmatimit të njëanshëm.
7. Nuk është ndërmarrë ndonjë operacion i veçantë në terren përderisa ka qenë në fuqi amnistia, nga kjo del se vetëm vetëdijesimi publik pa ndërmarrjen e operacioneve të veçanta mund të sjell vetëm 50 % sukses.

Përceptimi për dorëzimin vullnetar (anketa e janarit të vitit 2009)

D16. (DORËZIMI VULLNETAR) A mendoni që qeveria duhet të organizojë dorëzimin vullnetar të armëve të paligjshme? (luteni ta rrethoni njëren prej përgjigjeve) * E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj

% nga gjithsej

		E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj			Gjithsej
		Shqiptarë	Serb	Të tjerë	
D16. (DORËZIMI VULLNETAR) A mendoni se qeveria duhet të organizojë dorëzimin vullnetar të armëve të paligjshme? (rrethoni njëren përgjigje)	Po	40.4%	1.5%	8.9%	50.8%
	JO	7.4%	1.3%	2.9%	11.6%
	Nuk e di	18.6%	3.7%	5.6%	27.9%
	Ref/Nuk përgjigjet	.2%	9.3%	.2%	9.7%
	Gjithsej	66.6%	15.8%	17.6%	100.0%

D18. (DORËZIMI VULLNETAR) A mendoni se qytetarët duhet t'i dorëzojnë armët e tyre të paligjshme (Rrethoni një përgjigje) * E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj

% nga gjithsej

		E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj			Gjithsej
		Shqiptarë	Serb	Të tjerë	
D18. (DORËZIMI VULLNETAR) A mendoni se qytetarët duhet të dorëzojnë armët e tyre të paligjshme? (rrethoni një përgjigje)	Po	24.4%	7.6%	4.4%	36.5%
	Jo ende	19.4%	1.0%	5.0%	25.3%
	Jo	4.6%	.2%	2.4%	7.1%
	Nuk e di	17.8%	4.7%	5.2%	27.7%
	Ref/Nuk përgjigjet	.5%	2.4%	.5%	3.3%
Gjithsej	66.6%	15.8%	17.6%	100.0%	

D19. (DORËZIMI VULLNETAR) Kujt mendoni se qytetarët do të preferonin t'ia dorëzonin armët e tyre të paligjshme (rrethoni një përgjigje) * E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj

% nga gjithsej

		E6. (ETNICITETI) Cili është etniciteti juaj			Gjithsej
		Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	
D19. (DORËZIMI VULLNETAR) Kujt mendoni se qytetarët do të preferonin t'ia dorëzonin armët e tyre të paligjshme? (rrethoni një rreth përgjigje)	Policisë	48.8%	5.5%	9.6%	63.9%
	KFOR-it	7.8%	4.4%	2.9%	15.1%
	Kuvendit komunal	.3%	2.3%	.1%	2.7%
	TMK-së	4.9%		.6%	5.6%
	OSBE-së			.2%	.2%
	EULEX-it	.2%	.1%	.5%	.8%
	Nuk e di	4.0%	2.8%	2.4%	9.1%
	Ref/Nuk përgjigjet	.6%	.7%	1.4%	2.6%
Gjithsej		66.6%	15.8%	17.6%	100.0%

Korniza ligjore

Ligji për Armët, 2009

Përputhja me PVPE-në.

Vlerësimi i rrezikut

- 63 % e popullatës beson se armët iu përkasin grupeve kriminale;
- Rreth 50% e armëve të konfiskuara janë pistoleta dhe revolverë;
- Përveç kësaj, ekziston një numër tejet i madh i granatave, IED-ve dhe i mjeteve të tjera eksplozive që po konfiskohen;
- Deri më tani nuk është bërë ndonjë analizë për municionin;
- Policia nuk analizon nëse ka apo nuk ka armë që hynë në treg apo nëse këto armë kanë mbetur nga lufta;
- Nuk është bërë analizë e hollësishme se ku posedohen numri më i madh i armëve të paligjshme. (A është kjo e lidhur me vendet ku kanë luftuar të dy palët ndërluftuese ?);
- Gjendja politike dhe kontrolli jo i plotë i veriut të Kosovës;
- Pranimi i armëve në shoqëri;
- Analiza të pamjaftueshme për arsyen e mbajtjes së armëve nga njerëzit dhe kohën e dorëzimit të tyre.

II. Vizioni dhe misioni

1.1. Vizioni

Objektivi kryesor është ndërtimi i një shoqërie paqësore ku respektohen rendi dhe ligji, liritë qytetare dhe të drejtat e njeriut dhe ku dominon perceptimi i popullatës se jetojnë në një mjedis të sigurt.

1.2. Misioni

Qeveria e Kosovës ka mision që t'i mbrojë sigurinë dhe mirëqenien e të gjithë banorëve të Kosovës, si dhe të arrijë standarde ndërkombëtare në fushën e posedimit të armëve të vogla dhe të lehta. Përmes këtyre veprimeve, Kosova do të përgatitet edhe më shumë për procesin e liberalizimit të vizave dhe të integriteteve euro-atlantike.

1.3. Qëllimet strategjike

Përmes kësaj strategjie përcaktohet mënyra e zvogëlimit të armëve, municionit dhe të materialeve eksplozive, si dhe grumbullimi, vendosja në depo dhe shkatërrimi i armëve, të cilat gjenden në posedim të paligjshëm të qytetarëve në përputhje me Ligjin për Armët.

Përmes zbatimit të programit të Kosovës, duhet të arrihen qëllimet vijuese:

1. Përcaktimi i saktë i numrit dhe llojit të armëve që janë të pranishme në tregun e paligjshëm në Kosovë.

Do të bëhet një hulumtim nga zyra lidhur me anketat e zbatuara gjatë viteve të fundit (2003 – 2009) për të përcaktuar mangësitë lidhur me shifrat e sakta të armëve të paligjshme në Kosovë. Ky hulumtim nga zyra do të pasohet nga një anketë tjetër, që është bërë në vitin 2009, me qëllim të përcaktimit të sasisë së armëve të paligjshme në Kosovë. Kjo anketë për perceptimet dhe shpërndarjen e armëve do të krahasohet me analizën e bërë nga celula e policisë për analizën e krimit.

Qeveria e Kosovës do të jetë bartëse e këtij hulumtimi.

Ky hulumtim do të jetë i vlefshëm si bazë për nismën e grumbullimit të armëve, si dhe për numrin e armëve të konfiskuara dhe të incidenteve të dhunshme me armë gjatë tri viteve të fundit (2005 – 2008).

Përveç kësaj, Policia e Kosovës (Departamenti i Analizës së Krimit) DAK, do të kryej analizimin e incidenteve dhe arrestimeve të ndërlidhura me armë gjatë 24 muajve të fundit, që do të vlerësojë këto ngjarje sipas muajit dhe rajonit dhe do të vazhdojë me përgatitjen e përmbledhjes mujore për të gjitha incidentet dhe arrestimet e ndërlidhura me armë, të ndara sipas llojit (p.sh., mjetet e pashpërthyer, gjuajtjet, posedim i armës) dhe rajonit.

Zyra e UNMIKut/EULEX-it dhe Interpolit në Kosovë do të kërkojë që të gjitha shtetet anëtare të Interpolit t'i raportojnë Zyrës së UNMIK-ut/EULEX-it dhe Interpolit, të gjitha arrestimet të cilat përfshijnë qytetarët e tanishëm apo të mëparshëm të Kosovës, ku është i përfshirë posedimi i dy ose më shumë AVL-ve dhe çfarëdo incidenti apo arrestimi ku përfshihen eksplozivët dhe mjetet shpërthyes.

2. Krijimi i një kornize institucionale për zbatimin e suksesshëm të nismës për grumbullimin e armëve

2a. Hartimi i kornizës ligjore për dorëzimin vullnetar të armëve

Do të hartohet korniza ligjore, gjegjësisht ligji për dorëzimin vullnetar, legalizimin dhe çaktivizimin e armëve dhe dorëzimin vullnetar të municionit e të eksplozivëve, me ç'rast do t'u mundësohet qytetarëve që gjatë periudhës së paraparë për amnisti t'i sjellin armët, municionin dhe materialet eksplozive të paligjshme në pikat e grumbullimit apo që të thërrasin qendrën e thirrjeve, ku mund t'i raportojnë mjetet e paligjshme që duhet grumbulluar.

Ligji do t'i referohet udhëzimit administrativ, përmes së cilit do të përcaktohet plani operacional për zbatimin e nismës për dorëzimin e armëve, të municionit dhe të mjeteve eksplozive.

2b. Krijimi i komisionit drejtues për zbatimin e nismës

Përmes ligjit do të parashihet krijimi i komisionit drejtues, në të cilin së paku do të përfshihen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e FSK-së, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një organizatë joqeveritare. Ky komision drejtues do të udhëhiqet nga kryesuesi i komisionit kuvendor për çështje të brendshme dhe siguri.

2c. Krijimi i konsensusit politik

Do të fillohet debati në Kuvend nga kryetari i Kuvendit me qëllim që partitë politike të arrijnë në konsensus që ky proces ka interes shtetëror dhe çfarëdo që të jetë rezultati, të MOS përdoret për qëllime politike.

Debati në Kuvend po ashtu duhet të nxisë përkrahjen e partive politike dhe të degëve të tyre për krijimin e përkrahjes nga niveli bazë për këtë nismë.

2d. Rritja e përkrahjes për efikasitetin e gjykatave lidhur me rastet e posedimit të paligjshëm të armëve

Do të mbahet një diskutim i posaçëm me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Zyrën e Prokurorit, me qëllim të prioritetizimit të gjatë dhe dënimit të personave që përdorin në mënyrë të paligjshme armët.

Në mënyrë specifike, Ministria e Drejtësisë duhet të udhëzojë që të gjitha arrestimet ku janë të përfshira AVL-të dhe mjetet shpërthyes të trajtohen në mënyrë serioze dhe më ashpër, me rekomandim që këta individë të paraburgohen (e jo menjëherë të lirohen nga ana e gjykatave) derisa të kryhen hetimet për origjinën e armës dhe të bëhet vlerësimi forenzik për të përcaktuar nëse arma është përdorë në kryerjen e ndonjë krimi.

Po ashtu, është e rëndësishme që në rast të ndonjë incidenti ku përdorimi i armës apo mjetit shpërthyes ka rezultuar me vdekje apo lëndim atëherë të bëhet ndalimi në mënyrë automatike i të dyshuarit(ve), veçanërisht gjatë periudhës së amnistisë. Çfarëdo dënimi në lidhje me veprën e përshkruar më lartë do të rezultojë në rritjen e ndëshkimit (gjobë apo burgim).

2. Zhvillimi i kapacitete të palëve zbatuese

Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës do të organizojë aftësimin për punonjësit e pikave grumbulluese.

5. Realizimi i fushatës së vetëdijësimit të qytetarëve

4a. Faza 1: Informimi i qytetarëve rreth ligjit të ri për armët;

4b. Faza 2: Parandalimi i krimit, fokusimi më i madh dhe bashkëpunimi i policisë;

4c. Faza 3: Krijimi i përkrahjes nga niveli bazë për dorëzimin e armëve, municionit dhe të mjeteve eksplozive.

Në mënyrë specifike, fushata për vetëdijësim publik do të jetë e bazuar në analizat e hollësishme të grupit të synuar. Audiencia e synuar do të jetë e lidhur me objektivat specifike për të krijuar një mesazh të qëlluar dhe të pranueshëm.

Fushata për vetëdijësim publik është shtylla e çfarëdo iniciative për dorëzimin vullnetar të armëve dhe së paku do të përfshijë këto elemente:

- a. Informata të drejtpërdrejta për atë se çfarë është qëllimi i amnistisë, çfarë duhet të bëj popullsia dhe kur duhet ta bëj atë;
- b. Mesazhe për vetëdijesim për AVL-të, ku jepen informata se çfarë duhet të bëhet me municionin e pasigurt dhe mjetet shpërthyes;
- c. Mesazhe mbështetëse në lidhje me AVL-të ku jepen informata dhe paraqiten efektet e armëve ilegale dhe motivohet popullsia për të dorëzuar armët.

Fushata për vetëdijesim duhet të ketë parasysh në mënyrë të veçantë aspektin gjinor të posedimit të armëve por edhe të adresojë çështjen e pakicave, perceptimin e nevojës për armë për vetëmbrojtje dhe mbrojtje të familjes dhe çështjen e statusit në shoqëri.

5. Krijimi i planit operacional

5a. Krijimi i qendrës operative dhe i pikave të grumbullimit

Një qendër operative, e udhëhequr nga shefi i operacioneve, i cili do të vinte nga Ministria e FSK-së dhe zëvendësi i tij, që do të vinte nga MPB-ja, do ta udhëheqin operacionin. Zyrat e kësaj qendre do të ishin në Kuvend.

Delegacioni i qendrës së operacioneve do të ketë këta përfaqësues:

1. Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës (policët patrullues);
2. Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës (Ekipi për ndërhyrje);
3. Përfaqësuesi i FSK-së (MEDEVAC);
4. Përfaqësuesi i FSK-së (Ekipi i EOD-së);
5. Përfaqësuesi i MPB-së (përkrahja logjistike – mallrat e rrezikshme dhe ekipet policore të përcjelljes);
6. Përfaqësuesi i KFOR-it (objektet për ruajtje);
7. Përfaqësuesi i MAPL-së (lidhja me komunat);
8. Përfaqësuesi i (personi kontaktues për media dhe fushata për vetëdijesimin e qytetarëve);
9. Zëdhënësi;
10. Përfaqësuesi i UNDP-së (këshilltar teknik);
11. Përfaqësuesi i IC-së (ekipet monitoruese).

5b. Zhvillimi i operacioneve të bazuara në konfiskim dhe inteligjencë

Policia e Kosovës, Policia e EULEX-it dhe KFOR-i duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të mbledhur informata, duke filluar 3 muaj (apo edhe më herët) para fillimit të periudhës së amnistisë. Të gjitha indikacionet duhet të drejtohen në mënyrë përkatëse tek prokurori.

Përveç kësaj, Policia e Kosovës, Policia e EULEX-it dhe KFOR-i duhet të vendosin pika kontrolli për automjete në të gjitha rajonet e Kosovës, me përqendrim më të madh në ato rajone ku analizat kanë treguar se ka përdorim më të madh të armëve dhe mjeteve shpërthyes, në mënyrë që të largohen sa më shumë që është e mundur armë të paligjshme para dhe gjatë amnistisë në pajtim me ligjet e Kosovës. Përdorimi i mjeteve shpërthyes të PK, K-9 në pikat e kontrollit për automjete mund ta zmadhojë zbulimin.

Rekomandohet që të blehen K-9 shtesë për Policinë e Kosovës dhe t'i afrohet trajnim përkatës anëtarëve K-9 të Policisë së Kosovës që meren me mjete shpërthyes dhe armë që të zmadhohen aftësitë e Policisë së Kosovës në zbulimin e mjeteve shpërthyes gjatë ndalimit në trafik. Qëllimi do të jetë që anëtarët e K-9 të jenë të trajnuar dhe në vend para se të filloj zbatimi i veprimeve që mbështesin grumbullimin e AVL-ve para, gjatë dhe pas periudhës së amnestimit të dorëzimit.

Duhet të krijohet një linjë për thirrje anonime e cila funksionin në tri gjuhë dhe mundëson të raportohet posedimi i paligjshëm i këtyre mjeteve.

Bazuar në operacionet që varen nga informatat e inteligjencës dhe patrullat e shtuara në komunikacionin rrugor, policia do të zbatojë një numër më të madh të operacioneve të kërkimit dhe konfiskimit.

5c. Zhvillimi i operacioneve të kontrollit kufitar

Qendra e operimeve në kufi do të zhvillojë një plan operativ për shtimin e numrit të patrullave kufitare gjatë kohës së amnistisë dhe nismës për grumbullim. Bashkërendimi mes policisë kufitare dhe KFOR-it do të rritet.

Policia e Kosovës duhet të dërgojë K9 për mjete shpërthyes në vendkalime të ndryshme kufitare për të kontrolluar automjetet për mjetet shpërthyes, AVL-të dhe municionin i cili kontrabandohet brenda dhe jashtë Kosovës.

Qendra operative do të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë me qendrën operative.

5d. Zhvillimi i nismës për dorëzim

1. Urdhri për zhvillimin e operacioneve përfshinë:

a. Vendosijen e pikave grumbulluese

Për shkaqe sigurie, pikat grumbulluese do të vendosen nëpër komuna dhe jashtë zonave urbane. Pikat grumbulluese do të bazohen në një doracak të quajtur „ Pa viktima” dhe do të kenë një mekanizëm të rreptë të raportimit në qendrën e operimeve.

Pika e grumbullimit do të drejtohet nga 5 punonjës: 1 përfaqësues i PK-së(eksperti për armë), 1 përfaqësues i FSK-së (ekipi për çiminim), 1 përfaqësues i administratës komunale (administratori), 1 vullnetar nga një OJQ, 1 qytetar i caktuar për një komunë që ka vijuar aftësimin për dhënien e ndihmës së parë.

b. Armët në këmbim të mekanizmave stimules

Duke u bazuar në praktikat më të mira në rajon dhe përvojën në Kosovë me nismën „Armët në këmbim për zhvillim” zgjidhja që do të zbatohet do të jetë “Armët në këmbim të stimulimit”, përmes së cilës do të sigurohet nga një kupon për çdo person që dorëzon armën e paligjshme funksionale (një armë gjuetie dhe pistoleta/revolja do të japin të drejtën për një kupon; një pushkë automatike – 2 kuponë dhe për armët e lehta do të jepen 3 kuponë. Këta kuponë do të përdoren për tërheqjen publike të çmimeve në kanalin televiziv kombëtar. Tërheqja e parë do të bëhet pas dhjetë ditëve të grumbullimit të armëve, ndërsa tërheqja e fundit do të organizohet në fund të kësaj nisme. Për të ruajtur anonimitetin, çmimet do t’i referohen vetëm një numri dhe do të jepen nga UNDP-ja. Këto çmime do të përfshijnë kompjuterë dhe kurse, vauçerë falas për rrymë, tekste shkollore, etj.

c. Zhvillimi i ndihmës administrative

Do të jetë e detyrueshme që pika grumbulluese, qendra operative dhe depot të mbajnë evidencë të hollësishme, ashtu që asnjë armë, municion apo material eksploziv të mos humb në pikën grumbulluese, gjatë transportit për në depo, në depo e as gjatë transportit për në vendin e shkatërrimit.

d. Zhvillimi i ndihmës logjistike

Regjioni duhet të ofrojë ndihmesë logjistike të përditshme për dërgimin e armëve nga vendi i grumbullimit për në depo. Asnjë mjet nuk duhet qëndruar gjatë gjithë natës në vendin e grumbullimit.

e. Zhvillimi i ndihmës gjatë situatave emergjente

Disa lloje të incidenteve mund të ndodhin gjatë iniciativës për grumbullim, dhe qendra operative do të ketë kontakt të drejtpërdrejtë me një qendër të thirrjeve dhe vendet e grumbullimit, si dhe me vendet e depozitimit. Do të jetë e detyrueshme që një helikopter MEDEVAC të jetë në gjendje gatishmërie për urgjencat mjekësore, një helikopter për intervenim të menjëhershëm në rast se ndodh ndonjë sulm në vendin e grumbullimit, si dhe ekipi i çminimit në rast se në vendin e grumbullimit dorëzohet municion i pasigurt e që do të ketë nevojë për intervenim të menjëhershëm.

f. Zhvillimi i një strategjie komunikimi

Duke filluar tre muaj para fillimit të programit për mbledhjen e AVL-ve, do të realizohet një iniciativë multimediale në gjuhë të ndryshme, e cila do të përfshijë elemente të “shokut”, ku në mënyrë grafike do të theksohen ndikimet negative të ekspozimit ndaj dhe lëndimet e shkaktuara nga mjetet shpërthyes dhe armët e zjarrit. Këto reklama dhe raporte do të përcillen me lajmin për grumbullimin e AVL-ve dhe amnistinë.

Një zëdhënës i ndihmuar nga një ekip gazetarësh do të jetë në dispozicion për të dhënë komunikata shtypi, si dhe të rehat e fundit për ngjarjet e përcaktuara në datë dhe kohë. Asnjë rezultat nuk do të publikohet në asnjë komunë të Kosovës deri në përfundimin e kësaj nisme, pas së cilës do të shpërblehet komuna fituese. Po kështu, çdo ditë do të lëshohet një lejekalim për gazetarë, dhe gazetarëve do t’u lejohen vetëm vizitat e shoqëruara, me qëllim që ata të ruajnë fshehtësinë në pikat e grumbullimit.

6. Organizimi i shkatërrimit

Një shkatërrim publik i armëve, ku do të ftohen edhe mediet, do të organizohet 30 ditë pasi të mbyllen pikat grumbulluese. Prej 10 përfaqësuesve të pikave të grumbullimit do të formohet një komision për shkatërrimin e armëve, i cili do të vërteton se armët e grumbulluara në pikat e tyre janë shkatërruar në mënyrë efikase. Po ashtu, do të lëshohet një vendim i gjyqit për shkatërrimin e këtyre armëve sipas ligjit.

7. Vëzhgimi dhe vlerësimi i nismës

Një mision vëzhgues për zbatimin e nismës do të themelohet nga qendra operative, dhe do të përfshijë OSBE-në, EULEX-in dhe misionin diplomatik, të cilët do t’i raportojnë qendrës operative dhe përfaqësuesit të komunitetit ndërkombëtar. Ekipi vëzhgues do të vizitojë pikat grumbulluese së paku një herë në ditë bazuar në planin e zhvilluar nga qendra operative dhe të dërguar me postë elektronike. (EULEX-i ka ekspertë për mjete të pashpërthyer të cilët do të mund të përdoren për të monitoruar progresin e iniciativës për grumbullimin e AVL-ve).

1.4. Parimet themelore të programit shtetëror

Programi shtetëror është i bazuar në parimet e mëposhtme;

- Programi është i shtrirë në tërë Kosovën, vlen për të gjitha komunitetet dhe është jopolitik;

- Qytetarët i dorëzojnë armët, municionin dhe mjetet eksplozive pas një apeli publik për dorëzim vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive;
- Gjatë dorëzimit të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive nuk do të bëhet identifikimi e as regjistrimi i njerëzve, të cilët vullnetarisht dorëzojnë armët e tyre, municionin apo mjetet eksplozive;
- Nuk do të ketë procedura penale për personat që dorëzojnë vullnetarisht armët e tyre, municionin apo mjetet eksplozive;
- Zbatimi i një veprimi të sigurt, publik dhe transparent të grumbullimit dhe shkatërrimit të armëve, municionit dhe materialeve eksplozive;
- Parandalimi i keqpërdorimit të armëve, municionit dhe materialeve eksplozive gjatë grumbullimit dhe shkatërrimit.
- Në rast se kërkohet nga Policia e Kosovës, Policia e EULEX-it apo prokurori, arma specifike do të dërgohet në laboratorin e forenzikës për analiza të mëtutjeshme.

Plani i veprimit për zbatim

1. Përcaktimi i saktë i numrit dhe llojit të armëve të pranishme në tregun e paligjshëm në Kosovë

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
1	1.1. Përcaktimi i saktë i numrit dhe llojit të armëve të paligjshme.	1.1.1. Zbatimi i hulumtimit nga zyra për shpërndarjen e AVL-ve, të bazuar në anketat ekzistuese.	Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga UNDP KOSSAC.	Shtator 2009	5.000
				Shtator 2009	20.000
		1.1.2. Fillimi i anketës për azhurnim.	Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga UNDP KOSSAC.	Tetor 2009	5.000
		1.1.3. Analiza e anketës për shpërndarje të armëve.		Nëntor 2009	Nuk ka
		1.1.4. Krahasimi me statistikën për analizën e krimit të PK-së.	Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga UNDP KOSSAC.	Dhjetor 2009	10.000
	1.1.5. Fillimi i hulumtimit.	Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga			

			<p>UNDP KOSSAC.</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga PK-ja.</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme, e përkrahur nga UNDP KOSSAC.</p>	
--	--	--	--	--

Do të bëhet një hulumtim nga zyra lidhur me anketat e bëra gjatë viteve të fundit (2003 – 2009) për të përcaktuar mangësitë në numrin e saktë të armëve të paligjshme në Kosovë. Ky hulumtim nga zyra do të pasohet nga një anketë tjetër e zbatuar në vitin 2009 me qëllim të përcaktimit të sasisë së armëve të paligjshme në Kosovë. Anketa e përceptimit/shpërndarjes do të krahasohet me analizën e bërë nga celula e policisë për analizën e krimeve.

Qeveria e Kosovës do të jetë bartëse e kësaj ankete.

Anketa do të konsiderohet si pikënisje për nismën e grumbullimit të armëve, municionit dhe të materialeve eksplozive. Po kështu, do të merret parasysh edhe numri i armëve të konfiskuara dhe i incidenteve të dhunshme me armë gjatë tri viteve të fundit (2005 – 2008).

2. Krijimi i kornizës institucionale për zbatimin e suksesshëm të nismën për grumbullimin e armëve

Qëllimi strategjik	Objektivat specifikë	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
2	2.1. Zhvillimi i kornizës ligjore për dorëzimin vullnetar.	2.1.1 Themelimi i grupit punues për hartimin e ligjit për dorëzimin vullnetar të armëve, municionit dhe të mjeteve eksplozive. 2.1.2. Miratimi i këtij ligji.	Ministria e Punëve të Brendshme Qeveria e Kosovës	Shtator 2009 Tetor 2009 Nëntor 2009	Nuk ka
	2.2. Themelimi i grupit drejtues për zbatimin e programit për grumbullim.	2.2.1. Caktimi i anëtarëve të grupit drejtues.	Qeveria	Nëntor 2009	Nuk ka
	2.3. Krijimi i konsensusit politik.	2.3.1. Drejtuesi i komisionit drejtues të caktojë takime me udhëheqësit e partive politike.	Komisioni drejtues	Dhjetor 2009	5.000
		2.3.2. MPB-ja dhe UNDP-ja të paraqesin në Kuvend strategjinë dhe arsyetimin për zbatimin e saj.	MIPB UNDP KOSSAC	Janar 2010	Shpenzimet e shtypjes: 2000

		2.3.3. Kuvendarët nënshkruajnë marrëveshjen.	Komisioni drejtues	Janar 2010	Nuk ka
	2.4. Krijimi i konsensusit me komunitetet.	2.4.1. Kryesuesi cakton mbledhje me këshillin për çështje të komuniteteve.	Komisioni drejtues	Janar 2010	Nuk ka
	2.5 Rritja e përkrahjes për efikasitetin në gjykata lidhur me rastet e posedimit të paligjshëm të armëve.	2.5.1. Grupi punues me Zyrën e Prokurorit dhe me Ministrinë e Drejtësisë.	MPB UNDP KOSSAC	Janar 2010	Nuk ka

3. Ngritja e kapaciteteve për palët zbatuese

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
3	3.1. Hartimi dhe botimi i planprogramit të aftësimeve për grumbullimin e AVL-ve.	3.1.1. Doracaku i quajtur ‘ Pa viktima’. 3.1.2. Organizimi i pikave grumbulluese. 3.1.3. Reagimi gjatë emergjencave.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Tetor-nëntor 2009	20.000
	3.2. Hartimi dhe botimi i planprogramit të aftësimeve për shkatërrimin e	3.2.1. Procedurat e shkatërrimit të armëve.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Tetor – nëntor 2009	20.000

	armëve.				
	3.3. Hartimi dhe botimi i planprogramit të aftësimeve për mobilizimin e përkrahjes nga niveli bazë.	3.3.1 Mobilizimi i komuniteteve për dorëzimin e armëve të zjarrit.	Ministria e Punëve të brendshme UNDP KOSSAC	Tetor – nëntor 2009	20.000
	3.4. Organizimi i punëtorive për aftësim.	3.4.1. Aftësimi i përfaqësuesve të qendrave operacionale.	Ministria e Punëve të brendshme UNDP KOSSAC	Shkurt 2010	5.000
		3.4.2. 6 Punëtoritë regjionale për përfaqësuesit e pikave të grumbullimit të armëve.		Shkurt 2010	30.000
				Shkurt 2009	30.000
				Shkurt 2009	5.000
		3.4.3.6 Punëtoritë regjionale për mobilizimin e komuniteteve.		Mars 2009	10.000
		3.4.5. Punëtoritë e		Mars 2009	10.000

		<p>aftësimeve për shkatërrimin e armëve.</p> <p>3.4.6. Punëtoritë e aftësimeve për OJQ-në.</p> <p>3.4.7. Punëtorja e aftësimit për mjetet të informimit.</p>			
--	--	---	--	--	--

4. Zhvillimi i fushatës për vetëdijesimin e qytetarëve (FVQ)

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
4	4.1. Zhvillimi i fushatës për vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me dorëzimin e armëve.	4.1.1. Hartimi dhe miratimi i FVQ-së. 4.1.2. Hapja e tenderit për fushatë.	Ministria e Punëve të Brendshme	Dhjetor 2009	200.000
	4.2. Zbatimi i FVQ-së përgatitore.	4.2.1. Hapja e tenderit për fushatë. 4.2.2. Zbatimi i fazës 1. 4.2.3. Zbatimi i fazës 2.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Korrik 2009 Shtator – tetor 2009 Nëntor – dhjetor 2009	100.000
	4.3. Caktimi i zëdhënësit dhe personelit përcjellës (02).	4.3.1. Kontraktimi 4.3.2. Aftësimi i personelit.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Dhjetor 2009	20.000

5. Hartimi i planit operacional

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
5	5.1. Hartimi i procedurave standarde të punës për qendrën e operacioneve.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
	5.2. Hartimi i procedurave standarde të punës për pikat e grumbullimit.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
	5.3. Hartimi i planit operacional për operacionet e bazuara në informata të inteligjencës.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
	5.4. Hartimi i planit operacional për kontrollin e kufirit.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
	5.5 Hartimi i planit operacional për përkrahjen logjistike.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC SSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000

5.6 Hartimi i planit operacional për administratën.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC SSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
5.7. Hartimi i planit operacional për emergjenca.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC SSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
5.8. Hartimi i planit operacional për komunikime.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
5.9 Hartimi i planit operacional për monitorim.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000
5.10. Hartimi i planit operacional për shkatërrimin e armëve.	5.1.1. Hartimi dhe dhënia komisionit drejtues.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000

6. Organizimi i procesit të shkatërrimit të armëve

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
6	6.1. Përcaktimi i procedurave ligjore	Hartimi dhe miratimi.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	Nuk ka
	6.2. Përcaktimi i vendit të	Hartimi dhe miratimi.	Ministria e Punëve të	Nëntor-dhjetor 2009	Nuk ka

	shkatërrimit		Brendshme UNDP KOSSAC		
	6.3. Hartimi i procedurave standarde të punës për shkatërrimin e armëve	Hartimi dhe miratimi.	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000

DRAFT

7. Monitorimi dhe vlerësimi i nismës

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Veprimet	Institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse	Afati kohor	Buxheti në euro
7	7.1. Hartimi i procedurave standarde të punës për monitorim dhe vlerësim.	Hartimi dhe miratimi	Ministria e Punëve të Brendshme UNDP KOSSAC	Nëntor-dhjetor 2009	2.000

Implikimet buxhetore

Nr	Objektivi	Buxheti ne euro	Remark
1	Anketa	40,000.00	
2	Korniza institucionale	7,000.00	
3	Zhvillimi i kapaciteteve	150,000.00	
4	Fushata për vetëdijësimin e qytetarëve	322,000.00	
5	Hartimi i planit operacional	20,000.00	
6	Hartimi i planit për shkatërrimin e armëve	2,000.00	
7	Hartimi i planit për monitorim dhe vlerësim	2,000.00	
8	Zbatimi		
1	Mbledhjet e komisionit drejtues	5,000.00	
2	Qendra operative e kosos së punës	100,000.00	
3	Përkrahja logjistike	100,000.00	
4	Pikat e grumbullimit	100,000.00	
5	Armët në këmbim të stimulimeve	500,000.00	
6	Instrumentet përkrahëse (softueri)	50,000.00	
7	Reagimi në emergjenca	50,000.00	
8	Shkatërrimi i armëve	150,000.00	
9	Monitorimi dhe vlerësimi	50,000.00	
	GJITHSEJ	1,648,000.00	